



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 692, datë 15.11.2023

PËR
KUALIFIKIMIN DHE LEJIMIN PËR TË MARRË PJESË NË PROVIMIN E
VLERËSIMIT PROFESIONAL TË KANCELARES NË DETYRË NË GJYKATËN
E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER,
ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 15.11.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin *“Mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës, të kancelares në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier znj. {...}”*, përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj. {...} a Luli, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin dhe lejimin e saj për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës;

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...}, kancelare në detyrë pranë ish - Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht është kancelare në detyrë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier¹. Me vendimin nr. 496, datë 21.10.2020, *“Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”*, bazuar në nenet 53, 55 dhe 83, të ligjit nr. 98/2016, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* dhe vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”*, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës për znj. {...}, duke u caktuar me short relatore znj. {...} a Luli.

¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 ka vendosur që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier të emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

- 2.** Në datën 26.10.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu XI, të Vendimit 424/2020, kancelarja në detyrë znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:
- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë;
 - për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;
 - për të drejtën që kishte për të kërkuar përfundimisht relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
- Po ashtu, kancelarja në detyrë u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.
- 3.** Brenda afatit treditore, kancelarja në detyrë znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kancelarja në detyrë nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj, apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- 4.** Në datën 02.11.2020, bazuar në pikën 11, Seksioni B, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, kancelares në detyrë znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 15, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.
- 5.** Në datë 06.11.2020, u njoftua Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kancelarëve në detyrë, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë².
- 6.** Brenda afatit treditore, kancelarja në detyrë znj. {...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 2 javor (sipas pikës 68, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).
- 7.** Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 30.10.2020, bazuar në pikën 15, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenet 55, 56 dhe 83, të ligjit nr. 98/2016, për kancelarët në detyrë, ndër ta edhe për znj. {...}.
- 8.** Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, si dhe institucionet e tjera të cilat administrojnë informacionin e nevojshëm në kuadër të verifikimit të kushteve dhe

²Shih shkresën nr. 5678 prot., datë 05.11.2020, drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

kritereve ligjore të pozicionit, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

A. Për kushtet/kriteret e përgjithshme ligjore të pozicionit, sipas nenit 55, pika 1, të ligjit nr.98/2016

9. Për kancelaren në detyrë znj. {...} u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, përcaktuar në nenin 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, kushte të cilat përcaktohen si kritere të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil edhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) *Të jetë shtetas shqiptar* – Për këtë kriter, në dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme, pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Nuk rezulton ndonjë e dhënë për lënien ose heqjen e shtetësisë shqiptare për subjektin pas këtij momenti;
- b) *Të ketë zotësi të plotë për të vepruar* – Për këtë kriter, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) *Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur* – Zotërimi i gjuhës shqipe të folur dhe të shkruar prezumohet për çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar arsimin e detyrueshëm;
- d) *Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse* – Subjekti rezulton se është në kushte shëndetësore të cilat e lejojnë të kryejë detyrën pasi, sipas raportit mjeko-ligjor me nr. Rregjistri 1250, datë 19.03.2019, lëshuar nga Poliklinika Fier, ka rezultuar “I aftë për punë” dhe nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme për cenimin e kësaj aftësie;
- e) *Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje* – Sipas informacionit të përpunuar nga Struktura e Posaçme pranë KLGJ³, referuar dokumentacionit të përditësuar, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se znj. {...} nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Gjithashtu, nga të dhënat e dosjes personale dhe tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme që të cenojnë përmbushjen këtij kriteri;
- f) *Ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji* – Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas vetëdeklarimit të bërë nga kancelarja në detyrë znj. {...} në jetëshkrimin (CV) të depozituar në dosjen e personelit si dhe shënimet në librezën e punës, u konstatua se ajo ka qenë e punësuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier si kancelare që nga data 05.07.2011 dhe në vazhdim. Nga shkresa e datës 21.03.2019, e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e depozituar në dosjen e personelit, rezulton se kancelarja në detyrë nuk kapatur masa disiplinore. Nga viti 2019 dhe në vijim, në Këshillin e

³Shih shkresën me nr. 5347/142 prot., datë 20.04.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lartë Gjyqësor nuk rezultojnë të dhëna e as janë zhvilluar procedura për marrjen e masave disiplinore ndaj saj.

B. Për kriteret e veçanta ligjore të pozicionit, sipas nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 98/2016

10. Kriteret e parashikuara në nenin 56, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përcaktohen si kriteret e veçantapërpranimine nëpunësve civilë gjyqësorë. Për kancelaren në detyrë znj. {...} u verifikuan kriteret e veçanta, si më poshtë:

a) *Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit* – Në lidhje me këtë kriter, në nenin 56, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.98/2016 parashikohet se kandidatët për kancelar duhet të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislationit të arsimit të lartë. Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen personale të kancelares në detyrë znj. {...}, rezulton se, ajo ka depozituar dokumentet si më poshtë:

- “Diplomë në Gjuhë-Letërsi”, me nr. 4752, datë 10.07.1994, lëshuar nga Universiteti i Tiranës;
- “Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi”, me nr. 35, datë 04.09.2009, lëshuar nga Universiteti publik “Ismail Qemali”, Vlorë, pra ka përfunduar edhe ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, sipas përcaktimeve të legjislationit të arsimit të lartë, referuar nenit 124, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”;
- Vërtetim notash, lëshuar nga Universiteti publik “Ismail Qemali”, Vlorë.

Për sa më sipër, rezulton se znj. {...} ka përfunduar edhe ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, sipas përcaktimeve të legjislationit të arsimit të lartë, referuar pikës 3⁴ të nenit 124, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”, pra ka nivelin e përshtatshëm të arsimimit në raport me pozicionin e punës.

b) *Të ketë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin gjyqësor.* Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale, lidhur me marrëdhënien e punësimit, sipas shënimeve në librezën e punës dhe dokumentacionit të administruar në dosjen personale të kancelares në detyrë, rezulton se znj. {...} ka përvojë profesionale mbi tetë vjet dhe një përvojë profesionale aktive në sistemin gjyqësor. Konkretisht, kancelarja në detyrë ka përvojë profesionale aktive në sistemin gjyqësor, për periudhat si më poshtë:

- 20.04.1995 – 16.05.2011, si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- 16.05.2011 – 05.07.2011, si kancelare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- 05.07.2011 – e në vazhdim si kancelare në detyrë pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht kancelare në detyrë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të

⁴Në nenin 124, pika 3 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se :”3. *Diplomat përprogramet e integruaratë nivelit të dytë (DIND), të lëshuara para hyrjes në fuqitë këtij ligji, janë ekuivalente me diplomë universitare “Masterishkencave”.*

Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, duke pasur kështu minimalisht mbi pesë vjet përvojë profesionale në sistemin gjyqësor.

Kjo përvojë profesionale konfirmohet edhe nga përgjigja e përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që provon edhe derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sikurse më lart është cituar.

C. Për kriterin e pasurisë

11. Për kancelaren në detyrë znj. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë, u kërkuar raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor raportin “*Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kancelares në detyrë, {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier*”, me nr. 318/24 prot., datë 12.03.2021.

11.1. Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kancelarja në detyrë znj. {...} dhe personi i lidhur z. {...} (bashkëshorti) kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë dhe interesave private.

11.2. Po ashtu, sipas **Raportit të ILDKPKI-së, datë 12.03.2021**, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kancelarja në detyrë znj. {...} dhe personin e lidhur, duke konkluduar se për znj. {...}:

- a) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- c) ka mosdeklarim ndër vite;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11.2.1 Konkluzionet si më sipër, bazohen në rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI, në lidhje me sa vijon:

- i.** *Mosdeklarim i gjendjes cash të b/shortit, në deklaratat e interesave private “Periodike vjetore 2015 dhe 2016”, me burim të ardhurat e tij nga emigracioni në Itali (1998-2010) edhe nga dhënia me qira e pasurisë (2003-2011), shumë e cila ka shërbyer pjesërisht si burim (deklaruar 30.00 euro) për blerjen në datë 21.02.2017 të apartamentit me sip 122 m², rruga “Komuna e Parisit”, me vlerë 96.000 euro.*
- ii.** *Mungesë dokumentacioni justifikues financiar për të ardhurat nga emigracioni i b/shortit, përdorur si burimi shumë 60.000 USD, për blerjen e pasurisë njësi shërbimi me sip 132 m² në rrugën “Komuna e Parisit”, Tiranë, në vitet 2002-2003.*
- iii.** *Rezulton se kandidati ka deklaruar çmimin 5.100.000 lekë, për blerjen e apartamentit me sip 123 m², në rrugën “Komuna e Parisit” Tiranë, referuar kontratës së shitjes datë 01.12.2005, ndërkohë që sipas akt-Marrëveshjes datë 11.05.2004, vlera e apartamentit +*

- vend parkimit është 74.000 euro, shumë të cilën kandidati ka sqaruar se b/shorti e ka likuiduar plotësisht. ASHK ka regjistruar pasurinë me vlerën sipas kontratave të shitjes.
- iv. Deklarime të pasakta të pasurisë apartament me sipërfaqe 123 m², si dhe garazh me sipërfaqe 13.75 m², rruga “Komuna e Parisit”, Tiranë, në deklaratat e interesave private ndër vite.
 - v. Mungesë dokumentacioni justifikues të pjesshëm financiar për të ardhurat nga emigracioni b/shortit, përdorur si burim i shumës 74.000 euro për blerjen e apartamentit dhe vendparkimit në vitet 2004-2005.
 - vi. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor situacion/preventiv për vlerën e banesës në fshatin Qelëz, Pukë ndërtuar në periudhën 2005-2009, ku b/shorti zotëron 1/3 pjesë takuese.
 - vii. Të ardhurat nga qiraja, sipas kontratave të paraqitura rezultojnë në shumën rreth 4.156.000 lekë, për të cilat është konfirmuar pjesërisht pagesa e detyrimeve tatimore ndaj shtetit. Gjithashtu nuk konfirmohen pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruar nga qiradhënia në shumën 5.800.000 lekë, për periudhën 2003-2011, sipas deklaratës noteriale me nr. 637 rep., dhe nr. 378 kol., datë 26.02.2016, që kanë shërbyer pjesërisht, si burim për krijimin e pasurive.

11.3 Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” (pika 16, seksioni C, kreu IV dhe pika 73, seksioni B, kreu VI), Këshilli, nëpërmjet komunikimit elektronik më datë 23.03.2021, ftoi kancelaren në detyrë znj. {...} për të paraqitur shpjegime dhe çdo dokumentacion mbështetës lidhur me raportin e kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave private të përgatitur nga ILDKPKI.

11.3.1 Më datë 29.03.2021, me nr. 5678/39 prot., znj. {...} ka paraqitur pranë Këshillit kundërshtimet lidhur me raportin e ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin shtesë. Këshilli me shkresën nr. 5678/46 prot., datë 08.04.2021 ka dërguar pranë ILDKPKI-së shpjegimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, duke kërkuar, në përputhje me parashikimet e pikës 76, seksioni B, kreu VI të vendimit nr. 424/2020, trajtimin dhe përgatitjen e një raporti shtesë lidhur me subjektin.

11.3.2 Në datë 26.04.2021 ILDKPKI ka dërguar raportin shtesë me nr. 2990/35 prot., për kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruar nga subjekti, duke konkluduar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c) ka mosdeklarime ndër vite;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11.3.3 Konkluzionet si më sipër, bazohen në rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI, në lidhje me sa vijon:

- i. Mosdeklarim i gjendjes cash të b/shortit, në deklaratat e interesave private “Periodike vjetore 2015 dhe 2016”, me burim të ardhurat e tij nga emigracioni në Itali (1998-2010) edhe nga dhënia me qira e pasurisë (2003-2011), shumë e cila ka shërbyer pjesërisht si burim (deklaruar 30.000 euro) për blerjen në datë 21.02.2017 të apartamentit me sip 122 m², rruga “Komuna e Parisit”, me vlerë 96.000 euro.
- ii. Rezulton se kandidati ka deklaruar çmimin 5.100.000 lekë, për blerjen e apartamentit me sip 123 m², në rrugën “Komuna e Parisit” Tiranë, referuar kontratës së shitjes datë 01.12.2005, ndërkohë që sipas akt-Marrëveshjes datë 11.05.2004, vlera e apartamentit + vend parkimit është 74.000 euro, shumë të cilën kandidati ka sqaruar se b/shorti e ka likuiduar plotësisht. ASHK ka regjistruar pasurinë me vlerën sipas kontratave të shitjes.
- iii. Deklarime të pasakta të pasurisë apartament, me sipërfaqe 123 m², si dhe garazh me sip. 13.75 m², rruga “Komuna e Parisit”, Tiranë në deklaratat e interesave private ndër vite.
- iv. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor situacion/preventiv për vlerën e banesës në fshatin Qelëz, Pukë ndërtuar në periudhën 2005-2009, ku b/shorti zotëron 1/3 pjesë takuese.
- v. Të ardhurat nga qiraja, sipas kontratave të paraqitura rezultojnë në shumën rreth 4.156.000 lekë, për të cilat është konfirmuar pjesërisht pagesa e detyrimeve tatimore ndaj shtetit. Gjithashtu nuk konfirmohen pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara nga qiradhënia në shumën 5.800.000 lekë, për periudhën 2003-2011, sipas deklaratës noteriale me nr. 637 rep., dhe nr. 378 kol., datë 26.02.2016, që kanë shërbyer pjesërisht, si burim për krijimin e pasurive të bashkëshortit..

11.3.4 Lidhur me çdo konstatim të **Raportit të parë, menr. 318/24 prot., datë 12.03.2021**, kundërshtimet e znj. {...} në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

i. “Në vitin 2015 kam filluar të bashkëjetoj me z. {...}j dhe bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar⁵, kam përfshirë në deklaratën e interesave private periodike vjetore, edhe pasuritë, burimin e tyre të bashkëjetuesit. Martesën ligjore e kam lidhur në datën 16.06.2016.

Bashkëshorti {...}j ka qenë vetë subjekt deklarues (viti 2011 – 28.07.2015) dhe në deklaratën e tij, para fillimit në detyrë (viti 2011), ka deklaruar likuiditetet cash në shumën 50.000 euro, nga të ardhurat nga emigracioni. Ky likuiditet është krijuar nga bashkëshorti impërpara lidhjes së martesës dhe janë deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të Detyrës, si subjekt deklarues (Kryetar i Komunës Qelëz, Pukë), çka vërteton faktin se në asnjë rast nuk ka patur qëllim fshehje të të ardhurave në plotësimin e deklaratës periodike vjetore të vitit 2015 dhe 2016, si person i lidhur, në cilësinë e bashkëjetuesit, për sa kohë që këto të ardhura ishin deklaruar dhe njohur më parë nga organet përkatëse, konkretisht nga ILDKPKI-ja.

⁵**Neni 21, Deklarimi:** Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur.

{...}j ka vijuar të plotësojë deklaratat periodike vjetore në vitet 2012, 2013 dhe 2014, duke deklaruar në rubrikën “ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” se “nuk ka ndryshime”. Pas largimit nga detyra ai ka plotësuar deklaratën PLD në datën 28 Korrik 2015 dhe në këtë deklaratë, në rubrikën “ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, përsëri ka deklaruar se “nuk ka ndryshime”.

{...}j, në vitin 2016, si person i lidhur me mua, në cilësinë e bashkëjetuesit plotëson deklaratën periodike vjetore të vitit 2015. Duke patur parasysh se ka qenë subjekt deklarues, ai nuk kishte detyrimin të deklaronte të ardhurat e fituara nga puna në emigracion dhe ato nga dhënia e ambientit me qira, për sa kohë, ai deklarimin e fundit pranë ILDKPKI-së e ka bërë në 28 korrik 2015. Periudha kohore nuk ishte më shumë se 5 muaj (28.7.2015-31.12.2015) pa deklaruar dhe plotësuar deklaratën e interesave private pranë ILDKPKI-së, pavarësisht statusit të ndryshuar nga subjekt deklarues që ishte më parë, në person i lidhur me subjektin deklarues.

Nuk jemi përpara rastit të plotësimit të deklaratës para fillimit në detyrë, që personi i lidhur me subjektin deklarues, të deklaronte gjendjen cash, sipas kërkesave të nenit 4/1 të ligjit nr.9049/2003, të ndryshuar. Personi i lidhur me kancelaren, kishte detyrimin të plotësonte deklaratën periodike vjetore dhe jo atë para fillimit në detyrë, pasi unë isha subjekt deklarues që në vitin 2011.

Bazuar në legjislacionin e kohës në të cilin është plotësuar deklarata e Interesave private periodike vjetore (për vitet 2015 dhe 2016), {...}j nuk e ka ditur se duhet t'i deklaronte përsëri gjëndjencash që ai dispononte, gjatë plotësimit të deklaratës periodike vjetore si person i lidhur me kancelaren, deklaratë të cilën po e plotësonte, vetëm pas pesë muajve të plotësimit të deklaratës së interesave private pas largimit nga detyra në datën 28 korrik 2015.

{...}j ka plotësuar deklaratën e interesave private periodike vjetore, duke i qëndruar strikt të gjitha rubrikave (“ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” dhe “të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, ku përcaktohen periudha:..... për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit), si dhe kërkesave të formularit të Deklaratës PV.

Pra, {...}j, si person i lidhur me mua, subjektin deklarues, duhet të plotësonte dhe deklaronte çdo të ardhur të fituar për periudhën pesë mujore, si dhe duhet të deklaronte çdo ndryshim/pakësim/shtim të pasurisë, të të ardhurave, të gjendjes cash, gjatë periudhës 5 mujore (28 korrik 2015 – 31 dhjetor 2015). Plotësimi i deklaratës është bërë sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 7 “Deklarimi periodik vjetor” të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. I njëjti rregullim ligjor parashikohet edhe në shtesat dhe ndryshimet e fundit të këtij ligji (ndryshimet e ligjit nr.105/2018), përcaktuar në nenin 42/2 të tij.

Bashkëshorti, gjëndjen e cash-it e ka menduar se vazhdon të jetë gjëndje dhe duke qenë e tillë e pa ndryshuar, nuk e ka deklaruar. Duke marrë në konsideratë edhe vitet e bashkëshortit në emigracion 12 vjet, kjo gjë ka krijuar edhe vështirësi të të kuptuarit se si plotësohet një dokument i tillë.

Mos deklarimi është një gabim njerëzor, pasi bashkëshorti nuk kishte asnjë arsye të mos e deklaronte atë. Të ardhurat nga emigracioni janë të dokumentuara me dokumente të pakundërshtueshme, aq sa edhe një pjesë janë njohur nga ILDKPKI në shumën 142,000 euro. **Me dokumentet e reja të marra nga INPS, rezulton se të ardhurat nga emigracioni janë në shumën 182,956 euro.** Këtyre të ardhurave u shtohen edhe 11.395 euro të përfituara si asistencë për

qëndrimin pa punë në vitin 2010, duke u bërë në total të ardhurat nga emigracioni në shumën **194,351.48 euro**.

Po kështu, çdo vit nga 2003-2010 ka pasur të ardhura nga qiraja mbi 6,000,000 lekë, edhe këto të dokumentuara dhe të njohura nga ILDKPKI.

Në momentin e deklarimit të parë të pasurisë bashkëshortit tim i rezultojnë pasuri në shumën **154,000 euro** (60,000+74,000 +20,000 shtëpia në Qelëz, Pukë).

Diferenca midis të ardhurave dhe pasurisë del më e madhe se 50,000 euro dhe në këto kushte, deklarimi i bashkëshortit tim {...}j në deklaratën fillestare të vitit 2011 se ka pasur 50,000 euro cash është i mundur dhe i besueshëm.

TABELA E TE ARDHURAVE TE BASHKESHORTIT NGA EMIGRACIONI 2000-2010

Periudha		Lloji i kontributit	Kontributi të nevojshme për pension Euro	Shpërblimi ose të ardhurat Euro
01/03/2000	09/06/2000	Punë në vartësi	14.000	4.882,06
01/06/2000	31/12/2000	Punë në vartësi	29.000	9.592,67
01/01/2001	31/12/2001	Punë në vartësi	52.000	17.299,75
01/01/2002	31/12/2002	Punë në vartësi	52.000	18.157,00
01/01/2003	31/12/2003	Punë në vartësi	52.000	18.181,00
01/01/2004	31/12/2004	Punë në vartësi	52.000	18.768,00
01/01/2005	30/10/2005	Punë në vartësi	44.000	16.574,00
01/01/2005	30/10/2005	Sëmundje/aksidente	-	161,00
13/02/2006	31/12/2006	Punë në vartësi	46.000	16.932,00
01/01/2007	31/12/2007	Punë në vartësi	52.000	19.815,00
01/01/2008	31/12/2008	Punë në vartësi	52.000	20.367,00
01/01/2009	31/12/2009	Punë në vartësi	51.000	22.227,00
08/01/2010	09/08/2010	i papunë	31.000	11.395 (konfirmuar nga raporti i ILDKPI)
Shuma në Total			475.000	194.351,48

Nga viti 2011, deri në datën e blerjes së shtëpisë datë 21.02.2017, nuk rezulton se bashkëshorti dhe unë të kemi investuar duke blerë pasuri të paluajtshme, apo të jenë shtuar likuiditetet e dokumentuara, fakt ky që provon se gjendja e cash-it ka vazhduar.

Deklarimi i gjëndjes cash në vitin 2015 dhe 2016, në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 9049 është përgjegjësi e personit të lidhur dhe jo e imja, si kancelare në detyrë.

Një gabim i tillë njerëzor është fenomen edhe tek subjekte të tjera deklarues dhe me njohuri më të mira të ligjit që janë gjyqtar dhe prokuror, po ashtu edhe ILDKPKI. Ky është një fakt i njohur botërisht pasi vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit janë të botuara publikisht. Jo në pak raste nga këto dy organe janë vlerësuar si gabim njerëzor mosdeklarimi i gjëndjes cash nga subjekti deklarues dhe janë llogaritur të ardhurat dhe burimet e mosdeklaruara.

Gabimi njerëzor ka ndodhur në deklaratën e vitit 2015, 2016 dhe jo në deklaratën vetting dhe pasaktësitë e deklaratave vjetore nuk mund të vlerësohen si pasaktësi e deklaratës vetting.

ii. Pasuria është në pronësi të bashkëshortit tim {...}j, i përket periudhës paramartesore dhe është porositur nga ai, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 4429 rep., dhe nr.454 kol., datë 26.7.2002, duke përcaktuar edhe mënyrën e pagesës: kësti i parë 31.000 euro në datë 26.7.2002: kësti i dytë në Gusht 2003, me burim të ardhurat nga emigracioni.

ILDKPKI-ja nga njëra anë pranon si dokumente/prova: modelet CUD dhe librezë pune me nr.503/44 regjistri të bashkëshortit tëlëshuar nga shteti Italian, por nga ana tjetër nuk është bërë një analizë e tyre, apo të vlerësoheshin me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Është i vërtetë fakti se modelet CDU pasqyrojnë të ardhurat nga viti 2005 e më vonë, por e lidhur kjo provë me librezën e punës që tregon se marrëdhënia e punës ka qenë që në vitin 1999, bëhet bindëse se bashkëshorti ka krijuar të ardhura edhe më parë se viti 2005. Duke arritur në përfundimin që marrëdhënia e punës ka ekzistuar së paku që në vitin 1999, vit në të cilën pasqyrohet në librezë, dhe të ardhurat e pasqyruara në modelet CDU duhet të shërbenin për të llogaritur të ardhurat edhe për vitet para vitit 2005 me të njëjtën vlerë për numër vitesh.

Nga ILDKPKI-ja nuk është vlerësuar drejt parimi i proporcionalitetit, kohës së largët që janë krijuar të ardhurat dhe faktit që pasuria e bashkëshortit {...}j u vlerësua si e kancelares. Në këto kushte, arritëm të sigurojmë një dokument të ri të lëshuar nga **Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS) në datë 23.3.2021**, sipas të cilit pasqyrohen të ardhurat e bashkëshortit {...}j për vitet 2000-2010.

Kam sqaruar se burimi i deklaruar për blerjen e pasurisë së sipërcituar janë të ardhurat e fituara nga puna në emigracion 1998-2002 të bashkëshortit dhe për këtë është dorëzuar librezë e punës me nr. 50503-94 reg., e hapur në datën 23 qershor 1999, Venecia, Itali, në të cilën janë pasqyruar: (i) vitet e punës; (ii) profili i punës, “murator i kualifikuar” dhe “punëtor i kualifikuar i kategorisë D” dhe (iii) vendi i punës ku ka punuar bashkëshorti, konkretisht në “S.R.L. Nuova Veneziana Restauri 2000 S.R.L.” dhe “S.R.L. Nuovo Moschettiere”.

Sipas librezës së punës dhe të dhënave të pagës për {...}j nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), (EstratoConto, Previdenziale, RegimeGenerale, Venezia), me kod tatimor BLJFMR75D21Z100Z, rezultojnë të ardhura për {...}j si më poshtë:

Periudha		Lloji i kontributit	Shpërblimi ose të ardhurat Euro	Vendi i punës
01/03/2000	09/06/2000	Punë në vartësi	4.882,06	NuovaVeneziaRestauri 2000 S.R.L.
01/06/2000	31/12/2000	Punë në vartësi	9.592,67	S.R.L. NuovoMoschettiere
01/01/2001	31/12/2001	Punë në vartësi	17.299,75	S.R.L. NuovoMoschettiere
01/01/2002	31/12/2002	Punë në vartësi	18.157,00	S.R.L. NuovoMoschettiere
		Shuma në total	49.931,48	

Nga ky dokument provohet se {...}j ka siguruar të ardhura të dokumentuara për vitet 2000 – 2002 në shumën 49.931,48euro.

Në të ardhurat e mësipërme, nuk janë përfshirë të ardhurat e marra gjatë vitit 2003, të cilat në total për vitin kalendarik kanë qenë në shumën 18.157,00 euro. Nëse i referohemi pagesës së kryer

për pronën objekt shqyrtimi, pagesë e cila është bërë në Gusht të vitit 2003, atëherë në burim të krijimit të pronës përfshihet edhe një pjesë e të ardhurave të marra gjatë vitit 2003 nga puna në emigracion, konkretisht pranë S.R.L. Nuovo Moschettiere.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit {...}j dhe përplotësimin e kësteve të shumës prej 60.000 euro, ai është ndihmuar nga motrat që ka patur në emigracion. Shpenzimet për jetesë të bashkëshortit ishin minimale, pasi ka jetuar në shumicën e kohës në shtëpinë e motrës, {...} ({...}j), e cila ka ndërruar jetë në vitin 2019. Ajo ka qenë mbështetja e tij kryesore në Itali dhe e ka ndihmuar financiarisht. Duke patur parasysht se, motra e bashkëshortit ka ndërruar jetë, bashkëlidhur shpjegimeve i është vënë në dispozicion ILDKPKI-së, deklarata noteriale e djalit të saj, {...}.

Referuar sa më lart, provohet se konstatimi i ILDKPKI-së, për mungesë dokumentacioni justifikues financiar, për të ardhurat nga emigracioni i b/shortit, përdorur si burim i shumës 60.000 USD, për blerjet e pasurisë njësi shërbimi me sip. 132 m2 pranë Rr. “Komuna e Parisit” Tiranë, në vitin 2002 – 2003, nuk qëndron.

Provat e reja të siguruara si: (i) librezja e punës, lëshuar nga shteti Italian në emër të {...}j, lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane(INPS) në datë 23.3.2021;(ii) deklarata noteriale e djalit të të ndjerës Bardha Sadiku, si dhe duke u bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit,të çojnë në konkluzionin se bashkëshorti i kancelares në detyrë ka patur burime financiare për blerjen e pasurisë njësi shërbimi me sip. 132 m2 pranë Rr. “Komuna e Parisit” Tiranë.

iii. Kjo pasuri është në pronësi të {...}j, e porositur me Akt - Marrëveshje datë 11.5.2004 që konfirmon se Shoqëria “KIKA” Sh.p.k, i ka shitur shtetasit {...}j, apartament banimi me sip. 135 m2 + vend parkimi në vlerën totale 74.000 euro, nga e cila shuma 27.000 euro është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës ndërsa; brenda datës 30.9.2004 do të paguhet shuma 17.000 euro; brenda datës 30.12.2004 shuma 10.000 euro; brenda datës 30.4.2005 shuma 10.000 euro; në datë 30.7.2005 shuma 10.000 euro.

Konstatimi i ILDKPKI-së është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me dokumentet zyrtare, pasi ai ka deklaruar vlerë të pasurisë atë vlerë që është vendosur në kontratën e shitjes përfundimtare, si për apartamentin dhe për garazhin. Nga ana tjetër, kontrata e sipërmarrjes(akt-marrëveshja) në të cilën pasqyrohet vlera prej 74,000 euro ka pasur për objekt të saj dy pasuri(apartament+garazh), dhe në këto kushte, nuk mund të përcaktosh se sa ka qenë vlera e njëjës dhe sa e tjetrës.

Kontrata e shitjes është dokument që tregon kalim pronësie dhe përmbush elementët e një titulli pronësie, dhe jo kontrata e prenotimit/porosisë/sipërmarrjes. Duke pasur dy dokumente zyrtare që tregojnë të drejta pronësie, dhe se çmimi i pasurisë apartamentit prej 123 m2 nuk është përcaktuar i veçuar në kontratën e sipërmarrjes, bashkëshorti i kancelares në deklaratën vetting i ka dhënë përparësi kontratës së shitjes, si një dokument përfundimtar dhe se ky dokument bën kalimin e pronësisë, dhe mbi këtë dokument është regjistruar edhe vlera e pasurisë në ASHK. Pra, tashmë bëhet edhe një dokument tjetër zyrtar që pasqyron vlerën 51,000,000 lekë që pasqyron vlerën e pasurisë së blerë.

Formulari i deklarimit të pasurisë plotësohet duke u bazuar në dokumente zyrtare që tregojnë kalim pronësie dhe vlerën e përcaktuar në të. Nëse do të kishte rubrikë në formular që të kërkohej

dhe vlera të tjera të saj nëse në dokumente të tjera ka vlerë tjetër do të ishte plotësuar edhe me vlerën 74,000 euro.

Bashkëshorti imi është përmbajtur metodologjisë së primare është titulli i pronësisë dhe jo kontrata e sipërmarrjes, dhe është i mjaftueshëm të plotësohet sipas vlerës së një dokumenti.

Plotësimi i deklaratës së pasurisë vjetore të vitit 2011 me vlerë 74,000 euro tregon se {...}j nuk ka pasur asnjë qëllim që të fshehë vlerën reale të paguar për blerjen e pasurisë, por është çështje vlerësimi se si duhet plotësuar deklaratata.

Nga ana e bashkëshortit tim nuk ka pasaktësi në deklarinimin e vlerës së pasurisë apartament me sipërfaqe 123 m2 deri sa ai është bazuar në kontratën përfundimtare të shitjes, dhe se nga kontrata e sipërmarrjes nuk mund të nxirret një vlerë e saktë e kësaj pasurie, pasi kontrata e sipërmarrjes ka pasur për objekt blerje dy pasuri (apartament + vendparkimi nr.29).

Për pasaktësitë midis vlerës së kontratës së shitjes (5.100.000 lekë) dhe asaj të aktmarrëveshjes (74.000 euro) të deklaruara nga bashkëshorti im, si subjekti deklarues (në atë kohë ai ka qenë Kryetar Komune) nuk është marrë asnjëherë ndonjë masë administrative ndaj tij. Ai është thirrur nga ILDKPKI-ja për këtë pasaktësi, pasi ka dhënë shpjegime në vitin 2013 dhe 2016 dhe nuk ka patur asnjë masë tjetër të ndërmarrë nga ky institucion në atë kohë.

Pasaktësitë në deklarimet e personit të lidhur me mua nuk kanë pse të ndikojnë në vlerësimin tim, lidhur me kontrollin e pasurisë, pasi kjo pasuri është vendosur para martesës dhe është e personit të lidhur me mua.

Në deklaratën e plotësuar në nëntor të vitit 2020 është vendosur vlera e apartamentit sipas kontratës së shitblerjes së pronës, si i vetmi dokument ligjor që jep të drejtën sipas Kodit Civil të fitimit të pronësisë mbi pronën. Në nenin 163 të Kodit Civil parashikohet se, “Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë”. Një nga mënyrat e fitimit të pronësisë është edhe ajo e parashikuar në nenin 164 të këtij Kodi. Të mbahet parasysh se, vlera e paguar për pasurinë e bashkëshortit nuk është fshehur, përkundrazi ajo është bërë prezent në deklaratën e pasurisë të plotësuar nga bashkëshorti si subjekt deklarues në vitin 2011.

iv. {...}j ka në pronësi apartamentin me sip. 123 m2 dhe me numër pasurie nr. 8/386+2-12, me adrese: Bashkia Tiranë, Rruga “Komuna e Parisit”, regjistruar me nr.18281 në datë 30.9.2009. Sipas dokumentacionit, bashkëlidhur kartelës së pasurisë së paluajtshme, vlera e apartamentit është në shumën prej 5.100.000 lekë.

Midis palës shitëse shoqëria “Kika” dhe asaj blerëse {...}j është nënshkruar kontrata e shitblerjes me nr. 1054Rep., nr.285 Kol, datë 01.12.2005, sipas së cilës vlera e apartamentit është në shumën prej 5.100.000 lekë dhe në të është përcaktuar vetëm kalimi i pronësisë së pronës apartament.

Unë kam deklaruar vlerën 5.100.000 lekë në deklaratën e interesave private të plotësuar në muajin nëntor 2020, e cila është vlera sipas kontratës së shitjes, si i vetmi dokument ligjor, me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë për pronën, apartament me sipërfaqe prej 123 m2.

Po ashtu, edhe nga bashkëshorti në deklaratën Para Fillimit të Detyrës të viti 2011, duke i'u referuar kontratës së shitblerjes ka deklaruar vlerën prej 5.000.000 lekë, afërsisht sa vlera e pasqyruar në kontratë prej 5.100.000 lekë. Ndërsa në deklarinimin “Periodik Vjetor 2011” bashkëshorti ka deklaruar këtë apartament, duke i'u referuar akt-marrëveshjes me subjektin “KIKA” Sh.p.k. në vlerën aq sa ka paguar realisht prej 74.000 euro.

Sipas akt-marrëveshjes së datës 11.5.2004 konfirmohet se, Shoqëria “KIKA ” Sh.p.k., i ka shitur shtetasit {...}j, apartamentin e banimit me sip. 123 m² + vend parkimi në vlerën totale 74.000 euro. Në akt-marrëveshjen e datës 11.5.2004, në nenin 1 të saj, përcaktohet ndër të tjera se, [...] Shoqëria “Kika”, merr përsipër të ndërtojë apartamentin dhe t’i dorëzojë apartamentin [.....] me sip. 135 m², hapësirë e përbashkët 12 m², si dhe vend parkimi nr. 29. Më tej në nenin 2 të saj është rënë dakord midis palëve se, shuma e mësipërme do të likuidohej në këtë mënyrë: shuma 27.000 euro paguar në datën e nënshkrimit tëkontratësndërsa, brenda datës 30.9.2004 do të paguhet shuma 17.000 euro, brenda datës 30.12.2004 shuma 10.000 euro, brenda datës 30.4.2005 shuma 10.000 euro dhe në datë 30.7.2005 shuma 10.000 euro. Me pagimin e plotë të shumës prej 74.000 euro, {...}j bëhet pronar me të drejta të plota të këtij apartamenti dhe i vendit të parkimit nr. 29 duke u bërë hipotekimi i apartamentit në favor të tij.

Ndërsa, tek kontrata e shitjes me nr. 2025 rep., nr. 432 kol., datë 7.9.2009, kohë në të cilën janë mbyllur procedurat me shitësin, është vënë një shume formale 500.000 leke (për vendparkimin nr.29), pasi pagesat për këtë pasuri (vendparkimi) janë kryer konform akt-marrëveshjes të shitblerjes të datës 11.5.2004 me Shoq. “KIKA” Sh.p.k. Me dorëzimin e dokumentacionit ligjor, pranë ZVRPP-së, në datën 18.9.2009 ka dalë edhe vërtetimi hipotekori vend parkimit/garazhit me nr.29.

Meqënëse apartamenti dhe vendparkimi nr.29 janë dy pasuri të ndryshme, në akt-marrëveshjen e vitit 2004 është rënë dakort për një kontratë të vetme për të dyja, por, regjistrimi i tyre nuk mund të bëhej në një certifikatë pronësie, ndaj në këto rrethana janë bërë 2 kontrata shitblerje me palën shitëse Shoqëria “Kika”, një për apartamentin dhe tjetra për vendparkimin nr. 29, por që realisht, pagesa është një, e cila i përfshin të dyja pronat, sipas akt- marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2004.

Pra, prona është blerë në vitin 2004 dhe për të është paguar e gjithë vlera 74.000 euro deri në 30.7.2005. Për vend parkimin me nr. 29, me një sipërfaqe 13.75 m², pagesa është bërë bashkë me apartamentin, sipas akt-marrëveshjes. Vlera e plotë prej 74.000 euroështë paguar që në fillim, pasi, nëse nuk do të ishte paguar nuk do të ishin finalizuar kontratat e shitjes përfundimtare me Shoqërinë “Kika” dhe nuk do të ishte bërë regjistrimi pranë ZVRPP-së për pronën, apartament me sipërfaqe prej 123 m² dhe vendparkim me sipërfaqe prej 13.75 m².

Vlera e paguar prej tij prej 74.000 euro në asnjë rast nuk është fshehur nga bashkëshorti i kancelares, i cili në vitin e deklarimit të kësaj prone ishte vetë subjekt deklarues dhe ka bërë deklarimin e vlerës së paguar për pronën apartament dhe vendparkimi në deklaratën e interesave private të plotësuar prej tij.

Për pasaktësitë midis vlerës së kontratës së shitjes (5.100.000 lekë) dhe asaj të akt-marrëveshjes (74.000 euro) të deklaruara nga bashkëshorti im, si subjekti deklarues nuk është marrë asnjëherë ndonjë masë administrative ndaj tij. Ai është thirrur nga ILDKPKI-ja për këtë pasaktësi, pasi ka dhënë shpjegime në vitin 2013 dhe nuk ka patur asnjë masë tjetër të ndërmarrënga ky institucion në atë kohë.

Pasaktësitë në deklarimet e personit të lidhur me muanuk kanë pse të ndikojnë në vlerësimin e kësaj të fundit, lidhur me kontrollin e pasurisë time. Kjo pasuri është vendosur para martesës dhe është pasuri e personit të lidhur me mua.

Në asnjë rast nuk jemi përpara rastit të deklarimeve të pasakta të pasurisë apartament me sipërfaqe 123 m², si dhe garazh me sipërfaqe 13.75m², Rruga “Komuna e Parisit”, Tiranë, në

deklaratat e interesave private ndër vite, pasi në të dyja rastet, deklarimet nga subjekti deklarues janë bërë bazuar në aktet e lidhura mes palëve para noterit, siç janë akt-marrëveshja e datës 11.05.2004 dhe kontrata e shitblerjes e datës 01.12.2005.

Edhe nëse do të pranojmë se, jemi përpara rastit të konstatimit të pasaktësisë të deklarimeve në vite për subjektin deklarues {...}j, për pronat e fituara në periudhën paramartesore, këto konstatime, nuk afektojnë vlerësimin tërësor të kontrollit të pasurisë së kancelares {...}{...}, pasi ai vetëkaqënë subjekt deklarues në atë kohë dhe nuk ka qënë në cilësinë e personit të lidhur me kancelaren.

v. Konstatimi i ILDKPKI-së se bashkëshorti im, ka mungesë dokumentacioni justifikues të pjesshëm financiar për të ardhurat nga emigracioni, përdorur si burim i shumës 74.000 euro, është i gabuar.

Pas aktit të kontrollit kemi arritur të sigurojmë lejen e qëndrimit në shtetin Italian të bashkëshortit tim, e cila është lëshuar në date 04.12.1998, për motive pune, duke e paraqitur si provë të re. Nga ky dokument provohet se {...}j është rezident në Itali që nga data 04.12.1998. Paisja me një leje qëndrimi, në bazë të legjislacionit italian, vinte si pasojë e punësimit të bashkëshortit {...}j, përndryshe kjo leje nuk do të jepej nga autoritetet italiane. Në këto kushte, me këtë dokument provohet se ai ka jetuar dhe punuar në Itali që nga data 04.12.1998. Ai ka bërë përpjekje për të siguruar dokumenta të shoqërisë ku ka punuar, por koha e gjatë që ka kaluar e ka bërë të pamundur ruajtjen e dokumentacionit të kësaj natyre, gjithashtu duke pasur parasysh edhe afatet ligjore qëka shteti italian për ruajtjen e dokumentave, ndaj ka qënë e pamundur sigurimi idokumentave për nivelin e të ardhurave për periudhën 04.12.1998 - 01.03.2000.

Gjithsesi, bashkëshorti ime ka blerë këtë pasuri me të ardhurat nga emigracioni, dhe hua nga motrat. Në deklaratën për vetting është deklaruar se burimi i të ardhurave për pagesën e blerjes së apartamentit +vendparkim ka qënë puna e bashkëshortit si emigrant në vitet 1998-2010. Bazuar në të ardhurat ndër vite të tij, të cilat i ka fituar nga puna si emigrant i ligjshëm në shtetin italian, të ardhurat nga asistenca, për të cilat veprimet janë kryer nëpërmjet shërbimit bankar, të ardhurat e fituara nga puna përtej orarit normal të punës ku ai punonte, të ardhurat e fituara nga bakshishet, apo puna e dytë që kryente, krahas asaj për të cilën paguante detyrimet ndaj shtetit italian, justifikojnë bindshëm shlyerjen e shumës prej 74.000 euro për blerjen e pronës apartament banimi+vendparkim.

Shpenzimet për jetesë në vitet e emigrimit kanë qënë minimale, pasi ai ka jetuar më së shumti tek motra e tij {...} ({...}j), në shtëpinë e saj në Venezia, Itali.

Të ardhurat e fituara janë sjellë nga shteti italian për në shtetin shqiptar në mënyra të ndryshme si: një pjesë të të ardhurave, bashkëshorti i dërgonte nga llogaria personale në Itali në llogarinë personale që kishte pranë bankës BKT në Shqipëri; një pjesë të të ardhurave, bashkëshorti i depozitonte cash në BKT, kur vinte me pushime në Shqipëri; një pjesë të të ardhurave dërgohej në Shqipëri me pjestarë të ndryshëm të familjes, me miq e shokë.

Sipas statement bankar nga BKT, datë 10.11.2020, rezulton se për periudhën nga data 02.09.2003, deri në datën 14.09.2012, {...}j ka kredituar në llogari, rreth 94.675 euro, prej të cilave gjatë periudhës 2003 - 2004 janë depozituar cash nga {...}j shuma totale prej rreth 25.000 euro.

Sipas librezës së punës dhe të dhënat e pagës për {...}j nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), Venecia (EstratoConto, Previdenziale, Regime Generale, Venezia), me

kod tatimor BLJFMR75D21Z100Z, për vitet 2003 – 2010, rezultojnë të ardhura për {...}j 144.420 euro.

Periudha		Lloji i kontributit	Kontributi të nevojshme per pension Euro	Shpërblimi ose të ardhurat Euro
01/01/2003	31/12/2003	Punë në vartësi	52.000	18.181,00
01/01/2004	31/12/2004	Punë në vartësi	52.000	18.768,00
01/01/2005	30/10/2005	Punë në vartësi	44.000	16.574,00
01/01/2005	30/10/2005	Sëmundje/aksidente	-	161,00
13/02/2006	31/12/2006	Punë në vartësi	46.000	16.932,00
01/01/2007	31/12/2007	Punë në vartësi	52.000	19.815,00
01/01/2008	31/12/2008	Punë në vartësi	52.000	20.367,00
01/01/2009	31/12/2009	Punë në vartësi	51.000	22.227,00
08/01/2010	09/08/2010	i papunë	31.000	11.395 (konfirmuar nga raporti i ILDKPI)
Shuma në Total				<u>144.420</u>

Në vitin 2010, bashkëshorti im është paguar me asistencë në shtetin italian për periudhën nga data 01.01.2010, deri më datë 31.12.2010, fakt që vërtetohet edhe nga të dhënat e pagës për {...}j nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), si dhe nga fakti se për periudhën 26.10.2011, deri ne 11.4.2012, i janë kredituar në llogari bashkëshortit nga shteti italian për asistencë shuma prej 11.395 euro.

Kreditimet në llogarinë e bashkëshortit në Raiffeisen Bank, në shumën totale rreth 11.395 euro, janë nga asistenca nga shteti italian. Dokumenti i pranimit nga Zyra e Punës e shtetit italian konfirmon se bashkëshorti i kancelares, {...}j është trajtuar me ndihmë papunësie për një vit kalendarik, edhe pse ai jetonte në Shqipëri.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit tim për vitet 1998-2010. Për përplotësimin e shumës prej 74.000 euro, nëkohën e blerjes ai është ndihmuar nga motrat e tij që ka patur në emigracion, shumat e të cilave(huat) i ka shlyer pjesëpjesë, gjë e cila vërtetohet nga deklaratat noteriale të vëna në dispozicion si prova.

Bashkëshorti për të rritur ekonominë familjare ka punuar edhe punë të dyta, kryesisht në ndërtim, një sektor jo vetëm shumë i kërkuar, por edhe i mirëpaguar në shtetin italian në ato vite.

Pranë shoqërisë “NuovoMoschettiere S.R.L” ku edhe bashkëshorti ka vitet e punës të regjistruar në librezën e tij, ai ka punuar edhe përtej orarit normal të punës, ku paguhej relativisht ekstra jashtë busta pagës, edhe ditët e shtuna dhe të diela.

Tek e njëjta punë, ku shërbente me furnizim karburanti në portin e Venecias, jahteve luksoze dhe turistike, anijevedhe taksive (barkat), shumica e klientëve linin shuma të konsiderueshme bakshishi, të cilat shtonin të ardhurat e tij si emigrant.

Shpenzimet për jetesë të tij ishin minimale, pasi ka jetuar në shumicën e kohës në shtëpinë e motrës, {...} ({...}j), e cila ka ndërruar jetë në vitin 2019. Ajo ka qenë mbështetja e tij kryesore në Itali dhe e ka ndihmuar financiarisht, fakt që vërtetohet medeklaratën noteriale të djalit të saj, {...}, pasi motra e bashkëshortit ka ndërruar jetë.

Bashkëshorti, si emigrant, që nga viti 1998 ka bërë një punë të ligjshme në shtetin italian, ku për vitet 2000-2010 i ka të dokumentuara të ardhurat e tij.

Të ardhurat e fituara nga puna përtej kohës normale dhe nga puna në ndërtim (nëse i referoheni librezës së punës, profili i punës që ka kryer ligjërisht bashkëshorti është “murator i kualifikuar” dhe “punëtor i kualifikuar i kategorisë D”), si dhe bakshishet e klientëve të ndryshëm, konsiderohen të ardhura të fituara prej tij si emigrant. Bashkëshorti imka zgjedhur si mënyrë për të siguruar, përmirësuar jetesën e tij dhe të familjarëve, që të bëjë punë të vështirë dhe me orare të zgjatura, në kushte të vështira atmosferike e në terren, larg komoditetit që mund të ofronte një mënyrë tjetër për përfitimin e këtyre të ardhurave. Kjo zgjedhje e tij të vlerësohet si një shenjë integriteti e përgjegjshmërie.

Veprimet e bashkëshortit tim për të ardhurat e fituara nga puna në emigracion në pjesën më të madhe të tyre janë bërë nëpërmjet shërbimit bankar. Bashkëshorti ka fituar të ardhura të konsiderueshme nga puna në emigracion, dokumentuar këto nëpërmjet librezës së punës dhe Bilancit të llogarisë, Sigurimet Shoqërore, Rregjimi i Përgjithshëm, Venecia.

ILDKPKI-ja e bazon konstatimin në Raportin e saj, për mungesë dokumentacioni justifikues të pjesës së financiar, për të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit, pasi ajo i është referuar vetëm të ardhurave të dokumentuara në CUD-të e shtetit italian dhe jo në librezën e punës dhe në të dhënat e pagës për {...}j nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), datë 23.3.2021, ku dokumentohen të gjitha vitet e punës të kryera në shtetin Italian nga viti 1999, deri në vitin 2010.

Prona e mësipërme është pronë e blerë nga bashkëshorti përpara periudhës martesore dhe për të cilën ai si subjekt deklarues ka deklaruar të ardhurat dhe pronat e tija në deklaratat e plotësuar ndër vite prej tij, nga viti 2011 deri në vitin 2015.

Në cilësinë e provës, është dokumenti me të dhënat e pagës për {...}j nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), datë 23.3.2021, Itali, ku pasqyrohen të ardhurat për vitet e punës 2000-2010, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga ILDKPKI-ja, për faktin se ky dokument është siguruar pas nxjerrjes së rezultateve të raportit të ILDKPKI-së.

Shuma e të ardhurave për vitet 2004 - 2010, për {...}j është 126.239 euro. Në këtë shumë nuk janë llogaritur të ardhurat nga qiraja e lokalit 2003 – 2010, si dhe të ardhurat e vitit 2003 që janë përdorur për pasurinë “Garazh” njësi shërbimi siç është sqaruar më sipër⁶.

Si prova të tjera kam paraqitur edhe lejen e qëndrimit të lëshuar nga Kuestura e Venecias; librezën e punë të lëshuar nga shteti italian në emër të {...}j; provën e re të INPS; deklaratat e motrave të bashkëshortit; të ardhurat në vitet 2004-2010.

vi. Banesa në fshatin Qelëz, Pukë, ndërtuar në vitin 2005-2009, është një pasuri paramartesore, në të cilën bashkëshorti im është bashkëpronar me 1/3 e saj me pjesëtarët e tjerë të familjes së tij. Ajo është krijuar para fillimit në detyrë të bashkëshortit si Kryetar Komune.

Preventiv i një ndërtese/objekti është shuma e nevojshme që parashikohet të shpenzohet për kryerjen e një punimi, pra është dokumenti ku është përlllogaritur e përcaktuar kjo shumë.

Mungesa e dokumentacionit të ndërtimit të shtëpisë (ndërtim informal) është së pari objektive dhe nuk varet nga bashkëshorti i kancelares, apo familjarët e tij. Banesa është ndërtim pa leje dhe në këto kushte, nuk ka asnjë mundësi të sigurohej një dokumentacion i tillë. Në ndërtimin e shtëpisë ka kontribut me punë fizike të familjarëve të bashkëshortit dhe të afërme bashkëfshatarë, rrethanë që nuk të jep asnjë mundësi të dokumentosh shpenzimin.

⁶Për referim sqarimet në pikën “ii” të materialit.

Babai i bashkëshortit tim ka blerë materiale pa dokumente, ndërvarur kjo nga shitësit të cilët në përgjithësi nuk jepnin dokument për personat pa NIPT.

Në kohën që është bërë ndërtimi prej familjarëve tëbashkëshortit tim, ai ka qenë emigrant në Itali dhe nuk është menduar se do bëhej më vonë subjekt deklarimi pasurie dhe do t'i duheshin dokumentet e shpenzimeve për krijimin e pasurisë. Edhe ato dokumente që kanë qenë në atë kohë, nuk janë ruajtur nga babai i bashkëshortit, pasi nuk kishte asnjë arsye që t'i ruante.

Vetë qëllimi i ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” ka qenë amnistia e këtyre shkeljeve të bëra nga popullsia si rezultat i ndërtimeve pa kontroll.

Procedurë e ndjekur pas viti 2015 për legalizimin e banesës me regjistrimin e pronës në ASHK tregon qartësisht se kemi të bëjmë me ndërtim pa leje, prandaj mungesa e dokumentit situacioni/preventiv mbetet vetëm një akt formal, përpara një procedureligjore për legalizimin e banesës.

Bashkëshorti, në cilësinë e subjektit deklarues (si Kryetar Komune) në deklaratën e interesave private ka deklaruar banesën (shtëpi banimi) në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare tëtë zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i cili specifikon se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI [...] pasuritë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil. Ky deklarim është bërë prej tij në deklaratën PFD dhe atë PV, pavarësisht faktit që ndërtesa/shtëpia nuk ishte ende e regjistruar në ZVRPP, por as nuk kishin filluar procedurat e legalizimit të saj.

Konstatimi i ILDKPKI-së nuk ka lidhje me procesin e verifikimit të pasurisë sime, si kancelare në detyrë. Ky konstatim nuk ka asnjë pasojë për këtë proces dhe se mungesa e dokumentacionit justifikues ligjor situacion/preventiv, për vlerën e banesës në fshatin Qelëz, Pukë, është për shkak objektiv (ndërtim informal).

vii. Rezulton se {...}j ka në pronësi garazh me sipërfaqe prej 132 m², me nr. Pasuria nr. 6/475-G5, me adresë: Rruga “Komuna e Parisit”, Tiranë, regjistruar me nr. 00029470 në datë 29.1.2014, për të cilën ka lidhur kontratë të sipërmarrjes që në datën 26.7.2002 me “Lura” sh.p.k., e cila i përket periudhës paramartesore me mua.

Prona e mësipërme është dhënë nga bashkëshorti me qera nga viti 2003 deri në vitin 2020, nga ku rezulton se sipas deklaratave noteriale, kontratave të lidhura midis palëve, prona është përdorur nga qiramarrësit për aktivitet privat dhe nëkëto kushte detyrimin për deklarimin dhe pagimin në organet tatimore të tatimit të qirasë e ka patur individi përfitues.

- Në deklaratën noteriale nr. 637 rep., dhe nr. 378 kol., datë 26.2.2016, e cila ka ligjëruar marrëdhënien me {...} dhe {...}{...}j të dhënies me qira të pronës për vitet 2003-2011, vërtetohet se prona i është dhënë atyre për ushtrimin e aktivitetit privat. Fakti që prona “bodrum” është përdorur nga motra dhe vëllai i bashkëshortit, vërtetohet edhe ngastatementi i BTK-së, ku janë depozituar likuiditete nga shtetasi {...}{...}j; nga ekstrakti i OKR-së, që konfirmon se ky shtetas ishte i regjistruar me NIPT K914040040; si dhe nga dokumenti “librezë shëndetësore” lëshuar në vitin 2009, për {...} {...}j (motra e bashkëshortit), në të cilën pasqyrohet edhe adresa e pronës (bodrumit), që konfirmon se ky ambientshfrytëzohej prej tyre për biznes.

- Në kontratën e qirasëtë vitit 2011 me nr. 4518 rep., nr. 1013 kol, lidhur me qiramarrësin {...}, nëpërmbytje të kësaj kontrate tek neni “Qëllimi i përdorimit” parashikohet shprehimisht se, **“Ambienti do të përdoret nga ana ime për aktivitet privat”**. Marrëdhënia kontraktuale me këtë qiramarrës, i cili ka përdorur pronën për kryerjen e aktivitetit privat, ka vijuar deri në vitin 2013⁷.
- Në kontratën e qirasë të vitit 2014 me nr.110 kol., datë3.2.2014, lidhur me qiramarrësin Bledi Konomi, në përmbytje të kësaj kontrate parashikohet shprehimisht se, “Qiradhënësi {...}j në bazë të dokumenteve hipotekore është pronar i një dyqani të ndodhur në Tiranë, në rrugën “Medar Shtylla”, pallatet “Lura” nr.1, bodrum me sipërfaqe 132 m2. Këtë dyqan ja jep me qeraqiramarrësit Bledi Konomi për një afat një vjeçar....”.
- Në kontratën e qirasë të vitit 2015 me nr. 3278 rep., nr. 1172 kol, lidhur me qiramarrësin Elvan Labi, në përmbytje të kësaj kontrate parashikohet shprehimisht se, **“Tatimi mbajtur në burim do të paguhet nga qiramarrësi dhe do të zbritet qiradhënësit nga qiraja.”**
- Në kontratat e qirasë të lidhura pas viti 2015, (i) nr. 3278 rep., nr. 1172 kol., datë 08.09.2015, (ii) nr. 506 rep., dhe nr. 137 kol., datë14.2.2017, (iii) nr. 843 rep., dhe nr. 383 kol., datë 27.3.2017, (iv) nr. 3472 rep., dhe nr. 1717 kol., datë 4.12.2018; (v) nr. 507 rep., dhe nr. 176 kol., datë 11.5.2020, në përmbytje të kontratave është shprehur se, **“Palët kanë rënë dakort që tatimi mbi të ardhurën do të paguhet nga qiramarrësi, ndërsa tatimi i pasurisë do paguhet nga qiradhënësi”**.

Sipas nenit 8, gërma “d”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe pikës 2.3.6, të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, llogaritja e detyrimit tatimor për këtë kategori të ardhurash do të bëhet duke u bazuar nëkontratën përkatëse. Në rastin e kontratave të qiradhënies të lidhur ndërmjet dy individëve, detyrimin për deklarimin dhe pagimin në organet tatimore të tatimit të qirasë e ka individi përfitues.

Në rastin e kontratave të qiradhënies të lidhur ndërmjet një individi dhe një personi tëtatuëshëm të regjistruar në një nga mënyrat e parashikuara ligjore(QKB, Gjykatë, Tatime) dhe i pajisur me numër identifikimi të subjektit tëtatuëshëm (në IPT), detyrimin për llogaritjen, deklarimin dhe pagimin në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar e ka ky i fundit, por shuma e tatimit do të mbahet nga të ardhurat bruto që përfiton individi, sipas përcaktimit të ligjit në nenin 8-të tëpo këtij ligji.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me kontrata të qiradhënies, të lidhur ndërmjet një individi ({...}j) dhe një personi të tatuëshëm (persona të cilët kanë marrë pronën për ushtrimin e aktivitetit privat dhe e ushtrojnë atë).

Kur subjektet, të cilët janë tatim pagues nuk deklarojnë dhe nuk paguajnë detyrimet tatimore që lindin nga çdo burim i të ardhurave personale, ata janësubjekt i sanksioneve administrative të parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XIV, “Sanksionet”, neni 113, “Mosdeklarimi në afat” dhe 114 “Mosdeklarimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”.

⁷Në nenin 821 të Kodit Civil, Përsëritja e kontratës së qirasë, parashikohet se, Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit.Palët kanë vijuar marrëdhënien e tyre edhe një vit pas përfundimit të kontratës një vjeçare, sipas dakordësisë verbale midis tyre

Duke patur parasysh se, qiramarrësit kanë marrë pronën për aktivitet privat dhe për shkak të largësisë se qëndrimit, bashkëshorti im nuk është interesuar dhe nuk ka pasur dijeni nëse tatimi në burim i qirasë është shlyer apo jo prej tyre. Qiramarrësit kishin detyrimin për ta shlyer atë, referuar legjislacionit për procedurat tatimore, ndaj jemi përpara rastit që nuk duhet të penalizohet për mos pagimin e këtij detyrimi bashkëshorti im.

Pas vitit 2015, kohë në të cilën unë kam filluar të bashkëjetojë me subjektin e lidhur me mua, {...}j në qytetin e Tiranës, në të gjitha kontratat e qirasë është përcaktuar pala që do të kryejë tatimin në burim tëqirasë.

Të ardhurat nga qiraja të përfituara nga viti 2003, deri në vitin 2020 janë të gjitha të ardhura të ligjshme, në shumën prej 9.956.000 lekë⁸, si të ardhura të fituara nga dhënia me qira e pronës së personit të lidhur me mua, kancelarennë detyrë.

Konstatimi i ILDKPKI-së se, për të ardhurat nga qiraja në shumën rreth 4.156.000 lekë është konfirmuar pjesërisht pagesa e detyrimeve tatimore ndaj shtetit dhe se, nuk konfirmohen pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara nga qiradhënia në shumën 5.800.000 leke, për periudhën 2003 – 2011, nuk ngarkon me përgjegjësi personin e lidhur me mua.

Të ardhurat nga qiraja të përfituara në shumën prej 9.956.000 lekë nga viti 2003 deri në vitin 2020 janë të gjitha të ardhura të ligjshme.

11.3.5 Bazuar në raportin shtesë të dërguar nga ILDKPKI-ja, Këshilli, bazuar në Vendimin nr.424/2020 (pika 16, seksioni C, kreu IV dhe pika 73, seksioni B, kreu VI), nëpërmjet komunikimit elektronik me datë 04.05.2021 ftoi kancelaren në detyrës znj. {...} për të paraqitur shpjegime dhe çdo dokumentacion mbështetës lidhur me raportin shtesë kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave privatë të përgatitur nga ILDKPKI.

11.3.6 Më datë 10.05.2021, nëpërmjet postës elektronike znj. {...} ka paraqitur pranë Këshillit kundërshtimet lidhur me raportin shtesë të ILDKPKI-së, si më poshtë:

“ILDKPKI-ja nga tre konstatimet, sipas aktit të parë të kontrollit, ka konkluduar së fundmi vetëm në dy konstatime se, (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe (ii) ka mos deklarim ndër vite. Konstatime të cilat, jo vetëm që nuk janë argumentuar ligjërisht prej këtij Institucioni, por as edhe nuk janë dhënë shpjegime për të hedhur poshtë sqarimet dhe argumentet ligjore të dhëna nga kancelarja në materialin e dërguar nga KLGJ-ja, pranë ILDKPKI-së.

Konstatimet nuk kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me subjektin deklaruues {...}{...}, por me personin e lidhur me të, subjektin deklaruues {...}j (por i janë referuar kohës së konstatimeve kur ai nuk ka qenë person i lidhur si bashkëjetues/bashkëshort i kancelares). Ato i përkasin periudhës paramartesore.

Z. {...}j nga viti 2011 - 2015 (28 korrik 2015) ka qenë subjekt deklaruues, për shkak të pozicionit të punës që ka ushtruar, atë të Kryetarit të Komunës në Komunën Qelëz, Pukë dhe në vitin 2015 është bërë sërish subjekt deklaruues, si person i lidhur me mua, kancelaren në detyrë, {...}{...}, fillimisht

⁸ Të ardhurat nga qiraja, sipas kontratave dhe deklaratave të deklaruara nga qiradhënia në shumën 5.800.000 leke, për periudhën 2003 – 2011 dhe në shumën 4.156.000 lekë për periudhën 2011 – 2020.

në cilësinë e bashkëjetuesit (Shtator, viti 2015) dhe më pas, në vitin 2016 e vijim si person i lidhur, në cilësinë e bashkëshortit tim. Unë kam lidhur martesë ligjore me {...}j në datën 16.06.2016.

Në konkluzionet e nxjerra nga ILDKPKI-ja nuk ka asnjë pasaktësi, apo parregullsi drejtpërdrejt për mua, kancelaren si subjekt deklarues për vitet 2011 – 2020. Unë kam respektuar në mënyrë strikte ligjin duke deklaruar edhe bashkëjetesënqë në vitin 2015.

Në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, unë kancelarja në detyrë, si subjekt deklarues që prej vitit 2011 kam dorëzuar periodikisht “deklaratat e pasurisë dhe interesave private” para fillimit në detyrë, periodike vjetore për vitet 2011-2019 dhe asnjeherë nuk jam thirrur nga ILDKPKI në këto vite për pasaktësi apo gjetje të tjera. Për më tepër që, ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar asnjë pasaktësi dhe asnjë gjetje në kundërshtim me ligjin në deklaratën vetting të plotësuar në vitin 2020 nga ana ime, si kancelare në detyrë.

Konstatimet e ILDKPKI-së i përkasin pasurive të personit të lidhur, bashkëshortit tim, të krijuara para periudhës së martesës, të cilat janë pasuri vetjake në zbatim të nenit 77, të Kodit të Familjes dhe për rrjedhojë nuk duhet të afektojnë tek unë.

Sipas pikës 89, të Vendimit të KLGJ-së Nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, **skualifikimi i kandidatit** sa i përket pasurisë vendoset nga Këshilli, bazuar në rrethanat konkrete dhe **respektim të parimit të proporcionalitetit**, në rastin kur të dhënat, e marra nga burime të ligjshme, tregojnë se: a) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) kandidati nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) kandidati ka kryer fshehje të pasurisë; ç) kandidati ka kryer deklarim të rremë; d) kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Referuar sa më sipër, unë nuk gjendem përpara asnjë prej rasteve të cituara në pikën 89 të Vendimit të KLGJ-së nr. 424, datë 12.10.2020. Konstatimet e ILDKPKI-së kanë të bëjnë me bashkëshortin e saj, kohë në të cilën ai vetëkaqënë subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

Bashkëshorti ka qenë vetë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së nga viti 2011 - 2015 (28 korrik 2015). Ai është thirrur nga ILDKPKI-ja dy herë për pasaktësitë e evidentuara, pasi ka dhënë shpjegime në vitin 2013 dhe 2016, por nuk është marrë asnjeherë masë administrative, gjatë periudhës së deklaramit të tij, apo pas periudhës (pas largimit nga detyra) që bashkëshorti vetë ka qenë subjekt deklarues apo si person i lidhur me subjektin deklarues.

Nga ILDKPKI është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi bashkëshorti imka qenë subjekt i deklaramit të pasurisë për vitet 2011-2015, si kryetar komune në këto vite. Për deklarimet e tij të pasurisë është realizuar kontroll i plotë nga ILDKPKI ne vitet 2013 dhe 2016 dhe nga kontrolli ka rezultuar se deklarimet janë në përputhje me ligjin, pasi ndaj tij nuk është marrë asnjë masë administrative. Në bazë të nenit 25/1 pika 4 e ligjit nr. 9049⁹, si dhe pikës 70 te vendimit të KLGJ-

⁹Neni 25/1, pika 4 e tij parashikon: “Kontrolli ose rikontrolli i plotë i deklaramit kryhet çdo herë nga Inspektori i Përgjithshëm, kur ai ka të dhëna, nga burime të ligjshme, që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklaramin e një zyrtari, si dhe kur ka mospërputhje, që rezultojnë nga kontrolli aritmetik e logjik, të cilat tregojnë se burimet nuk mbulojnë ose nuk justifikojnë të drejtat pasurore të deklaruesit”.

së nr. 424, datë 12.10.2020¹⁰, kryerja e rikontrollit nga ILDKPKI për të njëjtën periudhë deklarimi për bashkëshortin tim, pa asnjë arsye, është në shkleje të nenit 25/1 të ligjit nr. 9049 dhe njëkohësisht shkel parimin e sigurisë juridike.

Siguria juridike presupozon, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme¹¹.

Mosdeklarimi në deklaratën vjetore, mungesa e dokumenteve, apo pasaktësi në vlerën e pasurisë, nuk kanë sjell asnjë pasojë negative, nuk janë bërë me qëllim për të fshehur pasuri, ato janë i përkasin një kohë të largët, dhe kanë të bëjnë me personin e lidhur, ndaj duhen vlerësuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sanksionuar në nenin 17, pika 1 të Kushtetutës¹², sipas nenit 12 dhe 109 të K.Procedurave Administrative, si dhe sipasparashikimeve të pikës 89 të Vendimit të KLGJ-së nr. 424/2020.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, proporcionaliteti vepron si një detyrim ndaj shteteve anëtare kur ato adoptojnë norma komunitare si rregulloret¹³ dhe direktivat pavarësisht nga fusha e veprimit komunitar dhe që ato duhet të respektojnë proporcionalitetin kur marrin masa për zbatimin e legjislacionit komunitar¹⁴.

Në bazë të nenit 22¹⁵ të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, bashkëshorti imka paraqitur deklaratë pasurie veçmas, pasi pasuritë për të cilat shprehet ILDKPKI-ja janë të ndara dhe 100% në pronësi të tij dhe për rrjedhojë nuk mbaj përgjegjësi për plotësimin e deklaratave të pasurisë prej tij, as edhe për të justifikuar burimin, por është ai vetënë bazë të nenit 22 të këtij ligji.

Për çdo konstatim të ILDKPKI-së parashtrij si vijon:

i. Bashkëshorti im, në cilësinë e subjektit deklarues si kryetar komune, ka deklaruar në deklarin "PFD 2011" likuiditete cash në shumën 50.000 euro, nga të ardhurat nga emigracioni. Deklarimi i shumës cash nga {...}j, vërteton faktin se në asnjë rast nuk ka patur qëllim fshehje të të ardhurave në plotësimin e deklaratës periodike vjetore të vitit 2015 dhe 2016, si person i lidhur, në cilësinë e bashkëjetuesit dhe më pas të bashkëshortit, për sa kohë që këto të ardhura ishin deklaruar dhe njohur më parë nga organet përkatëse, konkretisht nga ILDKPKI-ja. {...}j ka vijuar të plotësojë deklaratat periodike vjetore në vitet 2012, 2013 dhe 2014 duke deklaruar në rubrikën "ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit" se "nuk ka ndryshime". Pas largimit nga detyra ai ka plotësuar deklaratën PLD në datën 28 Korrik 2015 dhe në këtë deklaratë

¹⁰Pika 70 e vendimit KLGJ-se parashikon se: "Në rastin kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të Ligjit "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", verifikimi i pasurisë së kandidatit mbështetet në kopjen e deklarin të kandidatit, si edhe gjetjet dhe përfundimet e nxjerra gjatë procedurës së mëparshme të kontrollit të plotë të deklarin, dërguar nga ILDKPKI-ja në Këshill. Në çdo rast, Këshilli kryen veprimet e parashikuara nga shkronja "b", e pikës 67, të këtij vendimi."

¹¹Vendimi nr. 31, datë 18.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet nr. 15, datë 10.03.2016 dhe nr. 25, datë 28.04.2014 të po kësaj Gjyktae.

¹²P.Craig(2006), "EU Administrative Law", fq. 656.

¹³Çështja 29/95 "Pastoorsand Trans—CapGmbH kundër Belgjikës", viti 1997.

¹⁴Çështja 484/99 "Azienda Agricole EttoeRibaldi kundër AIMA", viti 2004.

¹⁵Neni 22 parashikon se: "kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.Anëtar i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara."

në rubrikën “ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” përsëri ka deklaruar se “nuk ka ndryshime”. Ai ka vlerësuar se është deklaruar njëherë shuma 50.000 euro cash dhe se nuk duhej deklaruar më pasi pas deklarimit të parë deklarohen vetëm ndryshimet.

{...}j, në vitin 2016, si person i lidhur me mua, në cilësinë e bashkëjetuesit plotëson deklaratën periodike vjetore të vitit 2015. Duke patur parasysh se ka qenë subjekt deklarues, ai nuk kishte detyrimin të deklaronte të ardhurat e fituara nga puna në emigracion dhe ato nga dhënia e ambientit me qira, për sa kohë, ai deklarimin e fundit pranë ILDKPKI-së e ka bërë në 28 korrik 2015. Periudha kohore nuk ishte më shumë se 5 muaj (28.7.2015-31.12.2015) pa deklaruar dhe plotësuar deklaratën e interesave private pranë ILDKPKI-së, pavarësisht statusit të ndryshuar nga subjekt deklarues që ishte më parë, në person i lidhur me subjektin deklarues.

Nuk jemi përpara rastit të plotësimit të deklaratës para fillimit në detyrë, që personi i lidhur me subjektin deklarues, kancelaren në detyrë të deklaronte gjendjen cash, sipas kërkesave të nenit 4/1 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar. Personi i lidhur me mua, kishte detyrimin të plotësonte deklaratën periodike vjetore dhe jo atë para fillimit në detyrë, pasi unë ishte subjekt deklarues që në vitin 2011.

{...}j, si person i lidhur me subjektin deklarues, duhet të plotësonte dhe deklaronte çdo të ardhur të fituar për periudhën pesë mujore, si dhe duhet të deklaronte çdo ndryshim/pakësim/shtim të pasurisë, të atë ardhurave, të gjendjes cash, gjatë periudhës 5 mujore (28 korrik 2015 – 31 dhjetor 2015). Ai ka plotësuar deklaratën e interesave private periodike vjetore, duke i qëndruar strikt të gjitha rubrikave dhe kërkesave të formularit të Deklaratës PV.

Në deklaratën e interesave periodike vjetore, në rubrikën “**ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit**”¹⁶ dhe në rubrikën “**të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private**”¹⁷ përcaktohet periudha e deklarimit, e cila përkon me periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit. Ndërsa në pikën 1 të nenit 7 “Deklarimi periodik vjetor” të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, parashikohet se, 1. Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi. Edhe në shtesat dhe ndryshimet e fundit të ligjit nr. 9049/2003, (ndryshimet e ligjit nr. 105/2018) në nenin 42/2 të tij parashikohet se, për efekt të deklarimit të interesave private të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2, të ligjit, të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrimin për deklarim, detyrohen të deklarojnë: a) Në deklarimin periodik vjetor, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

¹⁶Në këtë rubrikë përcaktohet se, përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

¹⁷Në këtë rubrikë përcaktohet: përshkruani hollësisht të ardhurat brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrat publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Bazuar në faktet e sipërcituara dhe legjislacionin e kohës në të cilin është plotësuar deklarata e Interesave private periodike vjetore (për vitet 2015 dhe 2016), {...} nuk e ka ditur se duhet t'i deklaronte përsëri gjendjen cash që ai dispononte, gjatë plotësimit të deklaratës periodike vjetore, si person i lidhur me subjektin deklaruues {...}{...}, deklaratë të cilën po e plotësonte, vetëm pas pesë muajve të plotësimit të deklaratës së interesave private pas largimit nga detyra në 28 korrik 2015.

Padijenja e këtij fakti rezulton i qartë dhe e provuar nga të dhënat e llogarive bankare të bashkëshortit në vitet 2012-2015. Nga llogaria në bankën që ai merrte pagën rezulton se çdo vit ka gjendje në datën 31 dhjetor. Nëse ai do të kishte lexuar me vëmendje formularin do të kishte plotësuar atë me gjendjen e cash-it në bankë.

Mos deklarimi është një gabim njerëzor, i ardhur nga mënyra se si e ka kuptuar bashkëshorti ligjin dhe formularin e deklarimit të pasurisë, pa një orjentim konkret, pasi bashkëshorti nuk kishte asnjë arsye të mos e deklaronte atë. Të ardhurat nga emigracioni në shumën 194,351 euro dhe nga qiraja mbi 6,000,000 lekë (43,000 euro) janë të dokumentuara dhe të njohura nga ILDKPKI. Nga ky institucion këto të ardhura janë llogaritur në justifikimin e pasurisë dhe është arritur në përfundimin se, pasuria e kandidatës dhe e bashkëshortit të saj është krijuar me të ardhura të ligjshme dhe të dokumentuara.

Nga ana tjetër, deklarimi i gjendjes cash në vitin 2015 dhe 2016 në bazë të nenit 22 të ligjit nr.9049 është përgjegjësi e personit të lidhur dhe jo e imja.

Një gabim i tillë njerëzor është fenomen edhe te subjekte të tjera deklarues dhe me njohuri më të mira të ligjit se ne, që janë gjyqtarë dhe prokurorë, fakt që ju jeni në dijeni, po ashtu edhe ILDKPKI. Ky është një fakt i njohur botërisht pasi vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit janë të botuara publikisht. Jo në pak raste nga këto dy organe janë vlerësuar si gabim njerëzor mos deklarimi i gjendjes cash nga subjekti deklarues dhe pasaktësia në deklarim nuk është ngritur në nivelin e masës disiplinore.

Ky gabim njerëzor ka ndodhur në deklaratën e vitit 2015, 2016 dhe jo në deklaratën vetting të viti 2020. Pasaktësitë e deklaratave vjetore nuk mund të vlerësohen si pasaktësi e deklaratës vetting. (e sqaruar kjo situatë edhe në pikën i. të kundërshtimeve për raportin e ILDKPKI-së me nr. 318/24 prot., datë 12.03.2021).

ii. dhe iii. Pasuria është në pronësi të {...}j, me sip. 123 m² dhe me numër pasurie nr. 8/386+2-12, me adresë: Bashkia Tiranë, Rruga "Komuna e Parisit. Sipas dokumentacionit, bashkëlidhur kartelës së pasurisë së paluajtshme, vlera e apartamentit është në shumën prej 5.100.000 lekë.

Midis palës shitëse shoqëria "Kika" dhe asaj blerëse {...}j është nënshkruar kontrata e shitblerjes me nr. 1054 Rep., nr.285 kol, datë 01.12.2005, sipas së cilës vlera e apartamentit është në shumën prej 5.100.000 lekë dhe në të është përcaktuar vetëm kalimi i pronësisë së pronës apartament. Vlera e shumës prej 5.100.000 lekë e deklaruar nga znj.{...} në deklaratën e interesave private të plotësuar në muajin nëntor 2020 është vlera sipas kontratës së shitjes, si i vetmi dokument ligjor, me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë për pronën, apartament me sipërfaqe prej 123 m².

Po ashtu edhe nga bashkëshorti në deklaratën Para Fillimit të Detyres të viti 2011, duke i'u referuar kontratës së shitblerjes ka deklaruar vlerën prej 5.000.000 leke, afërsisht sa vlera e pasqyruar në kontratë prej 5.100.000 lekë.

Nga ana tjetër, në deklarin "Periodik Vjetor 2011" bashkëshorti im ka deklaruar këtë apartament, duke i referuar akt-marrëveshjes së datës 11.5.2004 me subjektin "KIKA" Sh.p.k në vlerën aq sa ka paguar realisht prej 74.000 euro. Sipas sipas akt marrëveshjes rezultoi se, Shoqëria "KIKA" Sh.p.k, i ka shitur shtetasit {...}j, apartamentin e banimit me sip. 123 m2 + vend parkimi në vlerën totale 74.000 euro, ku në nenin 1 të saj përcaktohet ndër të tjera se, [...] Shoqëria "Kika", merr përsipër të ndërtojë apartamentin dhe t'i dorëzojë apartamentin [.....] me sip. 135 m2, hapësirë e përbashkët 12 m2, si dhe vend parkimi nr. 29.

Konstatimi i ILDKPKI-së se bashkëshorti im ka kryer deklarin të pasaktë për vlerën e pasurisë në deklaratë ndër vite është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me dokumentet zyrtare. Është deklaruar vlerë e pasurisë ajo që është vendosur në kontratën e shitjes përfundimtare, si për apartamentin dhe për garazhin. Nga ana tjetër, kontrata e sipërmarrjes (akt-marrëveshja) në të cilën pasqyrohet vlera prej 74,000 euro ka pasur për objekt të saj dy pasuri (apartament+garazh), dhe në këto kushte nuk mund të përcaktosh se sa ka qenë vlera e njërës dhe sa e tjetrës.

Gjithkush mund të bëjë vlerësim ndryshe, se të kush dokument zyrtar duhet bazuar për të plotësuar deklaratën e pasurisë kur për të njëjtën gjë, ka dy dokumente të ndryshme.

Kontrata e shitjes është dokument që tregon kalim pronësie dhe përmbush elementët e një titulli pronësie, dhe jo kontrata e prenotimit/porosisë/sipërmarrjes. Duke pasur dy dokumente zyrtar që tregojnë të drejta pronësie, dhe se çmimi i pasurisë apartament prej 123 m2 nuk është përcaktuar i veçuar në kontratën e sipërmarrjes, bashkëshorti im në deklaratën vetting i ka dhënë përparësi kontratës së shitjes, si një dokument përfundimtar dhe se ky dokument bën kalimin e pronësisë, dhe mbi të cilin është regjistruar edhe vlera e pasurisë në ASHK, pra 51,000,000 lekë që pasqyron vlerën e pasurisë së blerë.

Formulari i deklarin të pasurisë është plotësuar duke u bazuar në dokumente zyrtare që tregojnë kalim pronësie dhe vlerën e përcaktuar në të nëse ka të tillë. Nëse do të kishte rubrikë në formular, që të kërkoheshin dhe vlera të tjera të saj, do të ishte plotësuar edhe me vlerën 74,000 euro. Ai i është përmbajtur metodologjisë, se primar është titulli i pronësisë dhe jo kontrata e sipërmarrjes, dhe është i mjaftueshëm të plotësohet sipas vlerës së një dokumenti.

Megjithatë, ai nuk ka qenë i qartë në plotësimin e deklaratave të pasurisë se kë vlerë të vendoste. Në deklaratën fillestare në momentin e fillimit të detyrës si Kryetar Komune në vitin 2011 e ka plotësuar në vlerën që pasqyron kontrata e shitjes, ndërsa në deklarin vjetor të vitit 2011, e ka plotësuar duke u bazuar në kontratën e sipërmarrjes/porosisë. Në deklaratën vetting i është rikthyer versionit fillestar duke deklaruar vlerën e pasqyruar në kontratën e shitjes.

Në asnjë rast, {...}j nuk ka pasur asnjë qëllim që të fsheh vlerën reale të paguar për blerjen e pasurisë, duke pasqyruar vlerën prej 74,000 euro në deklaratën e vitit 2011.

Vlera e plotë prej 74.000 euro është paguar, pasinë të kundërt nuk do të ishin finalizuar kontratat e shitjes përfundimtare me Shoqërinë "Kika" dhe nuk do të ishte bërë regjistrimi pranë ZVRPP për pronën, apartament me sipërfaqe prej 123 m2 dhe vend parkim me sipërfaqe prej 13.75 m2.

Për pasaktësitë midis vlerës së kontratës së shitjes (5.100.000 lekë) dhe asaj të aktmarrëveshjes (74.000 euro) të deklaruara nga bashkëshorti im, si subjekti deklarues, nuk është marrë asnjëherë ndonjë masë administrative ndaj tij. Ai është thërritur nga ILDKPKI-ja për këtë pasaktësi, pasi ka dhënë shpjegime në vitin 2013 dhe 2016 dhe nuk ka patur asnjë masë tjetër të ndërmarrë nga ky institucion në atë kohë.

Pasaktësitë në deklaratimet e personit të lidhur me mua, nuk kanë pse të ndikojnë në vlerësimin e tim, lidhur me kontrollin e pasurisë sime. Kjo pasuri është vendosur para martesës dhe është pasuri e personit të lidhur me mua.

Unë kam deklaruar në deklaratën e plotësuar në nëntor të vitit 2020, vlerën e apartamentit të vendosur në kontratën e shitblerjes së pronës, si i vetmi dokument ligjor që jep të drejtën sipas Kodit Civil të fitimit të pronësisë mbi pronën. Referuar përmbajtjes së nenit 192 dhe 193 të Kodit Civil, në rastin konkret, qartazi parashikohet se, i vetmi akt i cili regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme është kontrata për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme. Ky akt, pra kontrata për kalimin e pronësisë, e cila ka vlerën prej 5.100.000 lekë është i vetmi dokument zyrtar që vërteton pronësinë dhe që regjistrohet pranë regjistrin të pasurive të paluajtshme.

Në rastin konkret, bashkëshorti im ka bërë deklaratimin e saktë sipas përcaktimeve të nenit 163, 164, 192 dhe 193 të Kodit Civil, por kurrsesi nuk jemi përpara rastit të deklaratimit të pa saktë.

Në nenin 163, të Kodit Civil parashikohet se, pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Një nga mënyrat e fitimit të pronësisë është edhe ajo e parashikuar në nenin 164, të këtij Kodi.

Vlera e paguar për pasurinë e bashkëshortit prej 74000 Euro nuk është fshehur, përkundrazi ajo është faktike, është paguar realisht tek shoqëria "Kika" prej bashkëshortit dhe bërë prezent në deklaratën e pasurisë të plotësuar nga bashkëshorti si subjekt deklarues në vitin 2011 si edhe në procesverbalet e deklaratimeve pranë ILDKPKI në vitet 2013 dhe në 2016.

Në këto rrethana, konstatimi ILDKPKI-së nuk qëndron, pasi unë kam deklaruar në përputhje me ligjin, çmimin 5.100.000 leke, për blerjen e apartamentit me sip. 123m², në Rr. "Komuna e Parisit" Tirane, referuar kontratës së shitjes datë 01.12.2005. Vlera e apartamenti + vend parkimi prej 74.000 euro është vlera fillestare, deklaruar nga bashkëshorti i saj, është e likuiduar plotësisht, por kjo vlerë nuk mund të përbënte deklaratimin e çmimit të shitjes, në kuptim të Kodit Civil, që lidhen me dispozitat ligjore të fitimit të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

Në të dyja rastet, deklaratimet nga subjekti deklarues {...}j janë bërë, bazuar në aktet e lidhura mes palëve, siç janë aktmarrëveshja e datës 11.05.2004 dhe kontrata e shitblerjes e datës 01.12.2005. Edhe nëse do të pranojmë se, jemi përpara rastit të konstatimit të pasaktësisë të deklaratimeve në vite për subjektin deklarues {...}j, për pronat e fituara në periudhën paramartesore, këto konstatime, nuk mund të afektojnë vlerësimin tërësor të kontrollit të pasurisë sime, si kancelare në detyrë.

Kjo pasaktësi në deklaratim është e personit të lidhur dhe jo e imja, por, edhe nëse e konstatojmë si të tillë, të vlerësojmë se nuk ka asnjë pasojë dhe nuk ngrihet në nivelin e masës disiplinore për kancelaren në detyrë. (e sqaruar kjo situatë edhe në pikën iv. të kundërshtimeve për raportin e ILDKPKI-së me nr. 318/24 prot., datë 12.03.2021).

iv. Në këtë banesë, e cila është pasuri martesore bashkëshorti zotëron 1/3 pjesë takuese dhe ajo është krijuar para se z. {...}j të ishte vetë subjekt deklarues. Duke qënë se banesa është ndërtim pa leje, në vitin 2015 kanë filluar procedurat e legalizimit të saj pranë Aluizni-t nga familjarët e z. {...}j (të tre, babai, vëllai dhe bashkëshorti).

Mungesa e dokumentacionit situacion/preventiv të ndërtimit të shtëpisë si nje objekt "Ndërtim pa leje" është për arsye objektive, nuk varej nga bashkëshorti {...}j apo familjarët e tij pasi nuk ka

paturasnjë mundësi të sigurohej një dokumentacion i tillë, bazuar në nenin 3, Përkufizime të ligji me Nr.9482, datë 03.04.2006, "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje".

ILDKPKI-ja në aktin e dytë të kontrollit nuk ka përfshirë asnjë shpjegim timin, lidhur me sqarimin e kuadrit ligjor që rregullon regjistrimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Dhe jo vetëm kaq, por ILDKPKI-ja në aktin e saj të kontrollit nuk ka dhënë asnjë argument ligjor, se përse ka arritur në konkluzion, mungesë të dokumentacionit ligjor të situacionit/preventivit, për vlerën e banesës, por i është referuar vetëm mungesës së një dokumenti.

Në asnjë dispozitë të ligjit me Nr.9482, datë 03.04.2006, "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje", të VKM-së nr. 411, datë 19.5.2010, "Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit", dokumenti situacion/preventivi, nuk parashikohet si kërkesë e dokumentacionit për regjistrimin e ndërtimeve pa leje. Ky dokument hartohet dhe është kërkesë e legjislacionit të zbatueshëm vetëm në rastet e ndërtimeve që kryhen me leje nga organet kompetente, por që në rastin konkret, në jemi përpara faktit të një ndërtimi pa leje.

Për të marrë lejen e legalizimit për banesën/shtëpinë duhet ndjekur e gjithë procedura e përcaktuar në ligj dhe aktet e dala në zbatim të tij. Sipas kërkesave të nenit 27, germa "ç" të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, domosdoshmërisht duhet të jetë likuiduar pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të vijuar procedurat me marrjen e lejes së legalizimit. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja llogaritet mbi vlerën e investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi.

Në ndërtimin e shtëpisë ka kontribut me punë fizike të familjarëve të bashkëshortit dhe të afërm e bashkëfshatar, rrethanë që nuk të jep asnjë mundësi të dokumentosh shpenzimin. Babai i bashkëshortit ka blerë materiale pa dokumente, ndërvarur kjo nga shitësit të cilët në përgjithësi nuk jepnin dokument për personat pa NIPT. Në kohën që është bërë ndërtimi prej tyre nuk është menduar se {...}i {...}j do bëhej më vonë subjekt deklarimi pasurie dhe do t'i duheshin dokumentet e shpenzimeve për krijimin e pasurisë.

Krijimi i këtyre dokumenteve është në një kohë që bashkëshorti nuk ka qenë person i lidhur me mua nuk mund të mbaj përgjegjësi për fakte të krijuara më parë, pa qenë e lidhur me të, në kohën e krijimit të tyre.

Mungesa e dokumentit situacion/preventiv për vlerën e banesës, jo vetëm që nuk është kërkesë e legjislacionit të zbatueshëm dhe akteve të dala në zbatim të tij, por as nuk përbën ndonjë vlerë në rastin konkret.

Konstatimi i bërë nga ILDKPKI nuk ka asnjë pasojë për këtë proces verifikimi për mua. Vlera e banesës mund të nxirret me metoda të tjera në bazë të çmimeve të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banësive për rrethin e Pukës për vitet e ndërtimit, ashtu edhe siç ka ndodhur në fakt nga ILDKPKI.

Bashkëshorti, në cilësinë e subjektit deklarues (si Kryetar Komune) në deklaratën e interesave private ka deklaruar banesën (shtëpi banimi) në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, pavarësisht faktit që ndërtesa/shtëpia nuk ishte ende e regjistruar në ZVRPP, por as nuk kishin filluar procedurat e legalizimit të saj. Bashkëshorti është thirrur nga ILDKPKI-ja dhe ka sqaruar situatën¹⁸ dhe gjatë kohës që ka qenë subjekt deklarues dhe më pas që nga viti 2015,

¹⁸Dokumentacioni ndodhet pranë ILDKPKI-së.

pas plotësimit prej tij të deklaratës së pasurisë PLD nuk është aplikuar asnjë masë administrative nga ILDKPKI-ja për të.

Nuk mund të ngarkohem unë me përgjegjësi, për veprime që janë kryer nga babai i bashkëshortit {...}j, për periudhën para martesës, si dhe duke patur parasyssh familjet tradicionale shqiptare, në të cilat ka mbizotëruar autoriteti prindëror. (e sqaruar kjo situatë edhe në pikën vi. të kundërshtimeve për raportin e ILDKPKI-së me nr. 318/24 prot., datë 12.03.2021).

v. Ky konstatim nuk ka asnjë pasojë për këtë proces verifikimi për pasurinë time, si kancelare në detyrë. Edhe nga ILDKPKI-ja, ky fakt nuk është cilësuar se sjell ndonjë pasojë në konkluzionin përfundimtar të raportit. Nga ky institucion të ardhurat nga qiraja janë quajtur të ligjshme edhe pse kancelarja nuk arriti të provoj pagesën e tatimit.

Mospagimi i tatimit nuk ka lidhje as me deklarimin e pasurisë, as me burimin e saj, as me deklarimin e rremë, as me konfliktin e interesit.

Duke qenë se nuk sjell asnjë pasojë për këtë proces, ILDKPKI-ja nuk kishte arsye ta pasqyronte si gjetje, pasi nga njëra anë e pasqyron dhe nga ana tjetër nuk vlerëson se ka sjell pasojë në këtë proces.

Të ardhurat nga qiraja rezultojnëse janë përfituar nga qiramarrës që kanë ushtruar aktivitet tregtar të regjistruar me NIPT pranë organit tatimor dhe sipas ligjeve tatimore, detyrimin për pagimin në organet tatimore të tatimit të qirasë e ka individ i përfitues, parashikuar kjo në nenin 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe pikën 2.3.6 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 të Ministrisë të Financave Ashtu si e kam sqaruar, burimi i të ardhurave në këtë rast është i ligjshëm, dhe një fakt i tillë është konstatuar edhe nga ILDKPKI duke i llogaritur këto të ardhura si të ligjshme. Të ardhurat që nuk kanë paguar tatim janë të paligjshme vetëm për magjistratët gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarët dhe prokurorëve në procesin e vettingut dhe jo për kancelarët në bazë të nenit D/3 i Aneksit të Kushtetutës.

Edhe nëse ka ndodhur një fakt i tillë që tatimi nuk është paguar, ka ndodhur para martesë në një kohë që bashkëshorti im nuk ishte person i lidhur me mua. Nga ana tjetër edhe në këtë kohë bashkëshorti im nuk ka pasur detyrim të paguante tatimin, pasi ka qenë detyrim i qiramarrësit, (e sqaruar kjo kjo situatë edhe në pikën vii. të kundërshtimeve për raportin e ILDKPKI-së me nr. 318/24 prot., datë 12.03.2021)”

11.3.7 Shpjegimeve me shkrim znj. {...} i ka bashkëlidhur dokumentacionin e referuar, si më poshtë:

1. Çertifikatë martesë nr. 000267646 nxjerre nga sistemi e-albania;
2. Të dhënat e pagës për {...}j nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), datë 23.3.2021;
3. Kërkesa (autorizim) për nxjerrje ekstrakti nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane (INPS), datë 23.3.2021;
4. Leje qëndrimi për të huaj, e {...}j lëshuar nga Kuestura e Venecias Itali në datën 04.12.1998;
5. Librezë pune për shtetas të huaj jashtë komunitare, me nr. 503/94 e {...}j;
6. Kërkesë për marrje kopje dokumentacioni, drejtuar ILDKPKI, datë 23.03.2021;
7. Kopje të 6 deklaratave nga subjekti deklarues {...}j për vitet 2011-2015 ne ILDKPKI;

8. Deklaratë noteriale nr. 809 rep. Nr. 249 kol. Datë 28.03.2021;
9. Deklaratë noteriale nr. 971 rep. Nr. 573 kol. Datë 28.03.2021;
10. Çertifikatë familjare nr. 016558394, lëshuar nga ZGJC 354, Bashkia Pukë.

12. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë {...} dhe personit të lidhur z. {...} (bashkëshorti), u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁹ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave²⁰.

12.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 22524/2prot, datë 04.12.2020, protokolluar në Këshill me nr. 5347/11prot, datë 07.12.2020, ka përcjellë informacionin e kërkuar nga KLGJ, për kancelaren në detyrë dhe personin e lidhur. Në këtë informacion nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

12.2 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 21636/1 prot, datë 14.12.2020, protokolluar në Këshill me nr. 5347/13 prot, datë 15.12.2020, ka përcjellë informacionin e kërkuar nga KLGJ, për kancelaren në detyrë dhe personin e lidhur. Në këtë informacion nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kancelaren në detyrë.

13. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, u ballafaquan me të dhënat sipas Raporteve të ILDKPKI-së. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kancelarja në detyrë, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, *“Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”*, i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim. Sa i përket të ardhurave të subjektit të cilat rezultojnë se e kanë burimin nga paga e saj si e punësuar pranë ish-Gjykatës së Rrethit Fier, rezulton se ato janë marrë në analizë në mënyrë të hollësishme nga ILDKPKI dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklaramin ose burimin e tyre.

14. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor²¹, ILDKPKI, me shkresën nr. 2940/1 prot., datë 17.06.2021, ka dërguar në format elektronik (CD) dosjen e kontrollit të plotë për kancelaren në detyrë znj. {...}. Duke krahasuar të dhënat e përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, (sipas CD) si dhe pretendimeve me shkrim të znj. {...}, të shoqëruara me dokumentacion nga vetë ajo rezulton se nuk konstatohet mangësi në deklaramin e kryer nga kancelarja në detyrë dhe deklarami është i saktë në përputhje me ligjin.

¹⁹Shkresa nr. 5347/5 prot., datë 19.11.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

²⁰Shkresa nr. 5347/4 prot., datë 19.11.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

²¹ Shkresa nr. 5678/86 prot., datë 07.06.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

15. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 18.11.2021, vendosi që për nevoja të procedurës së verifikimit, për kancelaren në detyrë {...} dhe për personin e lidhur me të, të kërkoj informacion ILDKPKI-së²², nëse nga ana e këtij institucioni është realizuar ndonjëherë kontroll i deklaratave periodike vjetore të saj, nga momenti kur është bërë subjekt deklarimi dhe nëse janë marrë masa administrative në kuadër të procedurës së kontrollit. Me shkresën nr. 2990/65 prot., datë 29.11.2021, ILDKPKI ka informuar se për kancelarien në detyrë {...} dhe për personin e lidhur me të nuk ka marrë masa administrative.

16. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 06.12.2021, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore dhe dokumentacionin e administruar në kuadër të saj, bazuar në pikën 25, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin dhe lejimin e kancelares në detyrë, znj. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional ose për skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të saj të punës.

17. Në mbledhjen plenare të datës 15.11.2023, Këshilli mori në analizë të gjithë dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë, duke e ballafaquar me të dhënat sipas të dy raporteve të ILDKPKI-së, si dhe duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, arriti në konkluzionet si më poshtë, konkretisht:

17.1 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI mbi mosdeklarimin e gjendjes cash të bashkëshortit, në deklaratat e interesave private “Periodike vjetore 2015 dhe 2016”, me burim të ardhurat e tij nga emigracioni në Itali (1998-2010) edhe nga dhënia me qira e pasurisë (2003-2011), shumë e cila ka shërbyer pjesërisht si burim (deklaruar 30.000 euro) për blerjen në datë 21.02.2017 të apartamentit me sip 122 m², rruga “Komuna e Parisit”, me vlerë 96.000 euro, u krahasua me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe duke u marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, u vlerësua se ky deklarim nuk sjell asnjë pasojë për saktësinë e deklaratës vetting të viti 2020. Sipas pikës 89, të Vendimit të KLGJ-së Nr. 424, datë 12.10.2020 “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor*”, kancelarja në detyrë vlerësohet për saktësinë e deklaratës vetting dhe jo për saktësinë e deklarimeve periodike vjetore, në kushtet kur këto të fundit kanë qenë efektivisht objekt verifikimi nga institucioni kompetente në çdo kohë, pa u kushtëzuar nga ndonjë rrethanë kontekste. Deklarimet Periodike Vjetore për këtë proces kanë vetëm vlerën e provës në lidhje me burimet e pasurive për deklaratën vetting. Konkretisht, mosdeklarimi i gjendjes cash në vitin 2015 dhe 2016 nga personi i lidhur me të drejtë janë vlerësuar nga ILDKPKI se nuk ndikon në mospërfshirje të shumës 30.000 euro si burim për blerjen në datën 21.02.2017, pasi sikurse u provua nga të dhënat tërësore të dokumentacioni të administruar burimet e tyre kanë qenë të prejardhura nga burime të ligjshme, punësimi i deklaruar rregullisht pranë autoriteteve përkatëse kompetente. Po kështu, kancelarja në mënyrë bindëse ka shpjeguar se gabimet në deklaratat periodike kanë qenë njerëzore dhe se ato janë ndrequr në deklaratën vetting, e cila rezultoi e saktë dhe e plotë. Për sa i përket pasurisë së bashkëshortit të saj, paraprakisht, në mbështetje të parimit

²² Shkresa nr. 2678/115 prot., datë 19.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

të proporcionalitetit, vihet në dukje se të ardhurat janë krijuar në një kohë relativisht të largët dhe përpara se ai të lidhte martesë me subjektin deklarues. Pra është fakt i provuar tashmë se bashkëshorti i saj ka pasur leje të rregullt qëndrimi në shtetin e huaj, prej vitit 1998. Për më tepër, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti deklarues rezulton se të ardhurat e tij që i përkasin periudhës 2000-2010, gjatë kohës që ka jetuar dhe punuar në emigracion, janë deklaruar rregullisht, fakt ky i provuar nga një institucion kompetent i huaj. Po kështu edhe mospërputhjet e evidentuara nga ILDKPKI-ja ndërmjet kontratave për blerjen e apartamenti dhe njësisë së shërbimit, nuk tregojnë fshehje, pasaktësi apo qëllime të tjera që mund të bien ndesh me ligjin, përkundrazi deklarimi i vlerës që figuron në kontratën e shitjes përfundimtare është vlera reale, e saktë dhe e qartë që është paguar për secilën prej pasurive (apartament dhe garazh). Kontrata e prenotimit/porosisë/sipërmarrjes ka vlerë ndërmjet palëve nënshkruese, pasi ajo ka si bazë të saj detyrimin e palëve për të qenë korrekte në përmbushjen e detyrimeve që kanë marrë përsipër, por ajo që prodhon efekte juridike edhe ndaj të tretëve është kontrata përfundimtare e shitblerjes, regjistrimi i së cilës në regjistrat hipotekorë e pajis blerësin me titullin e pronësisë. Për më tepër që kontratat janë dokumente zyrtare lehtësisht të aksesueshme nga institucionet, për pasojë mosdeklarimi i tyre apo gabimet që mund të ndodhin në deklarimin e tyre janë lehtësisht të evidentueshme në çdo kohë. E njëjta situatë është edhe për banesën në Pukë, e cila është një pasuri në të cilën ka jetuar familja e bashkëshortit, i cili ka 1/3 pjesë. Mungesa e dokumentacionin vlerësohet e justifikuar në kushtet kur ajo është ndërtuar pa leje, koha e largët e ndërtimit gjatë kohës që bashkëshorti ka qenë në emigracion dhe administrimi prej saj nga prindërit, të cilët nuk kanë pasur arsye dhe motiv për të ruajtur ndonjë dokument, për më tepër duke qenë edhe në padijeni të situatave që do të vinin në të ardhmen. Ndërsa, të ardhurat nga qiraja janë të ligjshme dhe për tatimin mbi to nuk mund të penalizohet as bashkëshorti dhe as subjekti, në kushtet kur detyrimin për të paguar tatimin në burim e ka pasur pala tjetër. Nga ana tjetër, vlen të evidentohet se bashkëshorti i znj. {...} ka qenë subjekt deklarues pranë IDKPKI-së në vitet 2011-2016 dhe ka dhënë shpjegimet përkatëse lidhur me mospërputhjet ndërmjet akteve, gjë e cila është konsideruar e tejkaluar dhe pa peshë në vlerësimin e ndonjë mase administrative në atë kohë.

Në këtë kontekst, nga verifikimet tërësore të kryera mbi deklaratimet e kancelares ndër vite, si dhe aktet dhe dokumentacioni i paraqitur për efekt të provueshmërisë së deklaratimeve, Këshilli, vlerëson dhe konkuldon se deklarata vetting është e saktë dhe në të nuk ka asnjë pasaktësi në deklarim si nga kancelarja në detyrë po ashtu edhe nga personi i lidhur në lidhje me deklarimin e gjendjes cash. Znj. {...} dhe personi i lidhur me të, kanë qenë jo vetëm të disponueshëm në kohë të shpejtë për të paraqitur të gjitha aktet dhe dokumentacionin provues, por edhe të dhënat e vëna në dispozicion prej tyre kanë qenë mjaftueshmërisht të plota për të arritur në përfundimin e saktësisë dhe plotësisë së deklaratës. Në këto kushte, Këshilli, vlerëson se në rastin e znj. {...} hetimi ka qenë i thelluar, gjithëpërfshirës dhe rezultatet e tij janë bindëse në përfundimin se kancelarja në detyrë nuk ka kryer asnjë shkelje në lidhje me saktësinë e deklaratës për deklarimin e gjendjes cash.

Gjithashtu, personi i lidhur {...}j ka qenë subjekt deklarimi që nga viti 2011 për shkak të detyrës si kryetar komune dhe në deklarimin para fillimit të detyrës në vitin 2011 e ka deklaruar gjendjen cash prej 50.000 euro, si të ardhura nga emigracioni. {...}j ka vijuar të plotësojë deklaratat periodike vjetore në vitet 2012, 2013 dhe 2014 duke deklaruar në rubrikën “ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” se “nuk ka ndryshime”. Në deklaratën e interesave periodike vjetore, në

rubrikën “**ndryshimi i pasurisë dhe burimi i krijimit**”, përcaktohet se, **përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.** Formulari i deklarimit dhe neni 7 i ligjit Nnr. 9049, datë 10.4.2003 në të cilin parashikohet se: “Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi”, kërkojnë deklarimin e ndryshimit të gjendjes së cash-it dhe jo gjendjen e tij në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Personi i lidhur ka ndjekur të njëjtën logjikë në plotësimin e deklaratës vjetore të pasurisë edhe në vitin 2015 dhe 2016. Edhe në këtë vit ai ka plotësuar deklaratën periodike vjetore dhe jo para fillimit të detyrës si subjekt i lidhur. Vetëm nëse do të plotësonte deklaratën para fillimit të detyrës si subjekt i lidhur ai kishte detyrimin të plotësonte gjendjen cash prej 50.000 euro. Personi i lidhur meqenëse më parë ishte subjekt deklarues për shkak të funksionit të kryetarit të komunës, funksion i cili u ndërpre në mesin e vitit 2015, në këtë vit ai mori statusin edhe të personit të lidhur dhe ka plotësuar deklarim periodik si person i lidhur duke krijuar vazhdimësinë si subjekt deklarues. Personi i lidhur është pyetur nga inspektorët e ILDKPKI në vitin 2013 dhe 2016 për të cilën është mbajtur procesverbal. Në këto deklarime ai ka mbajtur qëndrim dhe ka shpjeguar se cila ka qenë metodologjia e plotësimit të deklaratës vjetore të pasurisë. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, i cili parashikon se: “Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohehen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.”, këto dy procesverbale të hartuar mbështetur mbi një dispozitë ligjore nga organi kompetent, vlerësohen se përbëjnë pjesë komplementare e deklaratave periodike vjetore për sa i përket gjendjes së cashit në fund të vitit. Përpilimi i këtij dokumenti është bërë përpara organit kompetent dhe me të drejtë ILDKPKI pas këtyre shpjegimeve nuk e ka vlerësuar se personi i lidhur nuk ka kryer pasaktësi në deklarime. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se për këto të dhëna është tejkaluar tashmë çështja e ndikimit që ato mund të kenë në vlerësimin e subjekti, duke i çmuar ato pa peshë në vlerësimin përfundimtar, për më tepër, që ato sqaruar dhe konfirmuar sërish edhe në shpjegimet e dhëna nga kancelarja në detyrë, e cila në përmbushje të detyrimeve të saj për shkak të barrës së provës, ka dhënë mjaftueshmërisht shpjegime të pranueshme dhe që bindin në saktësinë dhe plotësinë e deklaratës së pasurisë.

17.2 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI se znj. {...} ka deklaruar çmimin 5.100.000 lekë, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 123 m², në rrugën “Komuna e Parisit” Tiranë, referuar kontratës së shitjes datë 01.12.2005, ndërkohë që sipas akt-Marrëveshjes datë 11.05.2004, vlera e apartamentit + vend parkimit është 74.000 euro, shumë të cilën ajo ka sqaruar se b/shorti e ka likuiduar plotësisht, ASHK ka regjistruar pasurinë me vlerën sipas kontratave të shitjes, u krahasua me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe duke u marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, u vlerësua se deklarimi i cmimit të pasurisë është bërë në bazë të kontratës së

shitjes. Kontrata e shitjes është dokument që tregon kalim pronësie dhe përmbush elementët e një titulli pronësie, si i vetmi dokument ligjor që jep të drejtën sipas Kodit Civil të fitimit të pronësisë mbi pronën. Në nenin 163, të Kodit Civil parashikohet se, pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Një nga mënyrat e fitimit të pronësisë është edhe ajo e parashikuar në nenin 164, të këtij Kodi. Po kështu, në nenin 192, të Kodit Civil, parashikohet se, sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjëndjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji. Ndërsa në nenin 193, të Kodit Civil parashikohet se, duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: *a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjestimin vullnetar të tyre;...*”. Referuar përmbajtjes së nenit të sipërcituar dhe rastit konkret, parashikohet se, i vetmi akt i cili regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme është kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme. Ky akt, pra kontrata për kalimin e pronësisë, e cila ka vlerën prej 5.100.000 lekë është i vetmi dokument zyrtar që vërteton pronësinë dhe që rregjistrohet pranë regjistrin të pasurive të paluajtshme. Në rastin konkret, kancelarja në detyrë (personi i lidhur) ka bërë deklarin e saktë sipas përcaktimeve të nenit 163, 164, 192 dhe 193 të Kodit Civil, dhe nuk jemi përpara rastit të deklarin të pa saktë, ajo i është përmbajtur me përpikmëri kontratës, e cila përbën edhe bazën ligjore dhe përfundimtare të marrëdhënies ndërmjet palëve private të saj, sikurse blerësi dhe shitësi dhe që prodhon edhe efekte ndaj të tretëve, sikurse regjistrimi dhe pajisja me çertifikatë pronësie. Kontrata përbën provë bindëse, cila vërteton pa mëdyshje dhe plotësisht jo vetëm marrëdhënien ndërmjet palëve por edhe elementët e saj, veçanërisht çmimin për blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Nga ana tjetër personi i lidhur ka qenë në vështirësi në deklarin e vlerës së saktë të apartamentit dhe garazhit nëse do të referohej te kontrata e sipërmarrjes, pasi të dy pasuritë janë blere me një vlerë totale prej 74.000 euro dhe nuk kanë qenë të ndara. Në deklaratën fillestare në momentin e fillimit të detyrës si Kryetar Komune (Personi i lidhur) në vitin 2011 e ka plotësuar në vlerën që pasqyron kontrata e shitjes, ndërsa në deklarin vjetor të vitit 2011, e ka plotësuar duke u bazuar në kontratën e sipërmarrjes/porosisë. Në deklaratën vetting i është rikthyer versionit fillestar duke deklaruar vlerën e pasqyruar në kontratën e shitjes. Plotësimi i deklaratës së pasurisë vjetore të vitit 2011 me vlerë 74,000 euro tregon se prej personit të lidhur nuk ka pasur asnjë qëllim që të fsheh vlerën reale të paguar për blerjen e pasurisë, as në pamundësi financiare, por është thjesht çështje interpretimi të ligjit se si duhet plotësuar deklarata. Vështirësia në pasqyrimin e saktë të të dhënave, përbën një faktor që duhet të merret në konsideratë në kushtet kur e vlerësuar në tërësi kjo situatë dukshëm krijohet bindja se qëllimi i personit të lidhur nuk ka qenë fshehja apo deklarimi me dashje i pasaktësive, por padijenja në atë kohë për mënyrën se si deklarata duhet të plotësohej. Për më tepër, që sikurse është theksuar edhe më lart, kontratat përbëjnë dokumente që janë lehtësisht të aksesueshme mbi marrëdhënien që kanë ekzistuar apo zhvillohen ndërmjet palëve dhe vërtetësia e tyre është lehtësisht e verifikueshme në çdo kohë.

17.3 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI mbi deklarime të pasakta të pasurisë apartament, me sipërfaqe 123 m², si dhe garazh me sip. 13.75 m², rruga “Komuna e Parisit”, Tiranë në deklaratat e interesave private ndër vite, u krahasua me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe duke u marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, u vlerësua se vlera e paguar për

pasurinë e bashkëshortit prej 74000 Euro nuk është fshehur, përkundrazi ajo është faktike, sepse është paguar realisht tek shoqëria “Kika” prej bashkëshortit të kancelares në detyrë dhe bërë prezent në deklaratën e pasurisë të plotësuar nga bashkëshorti i saj si subjekt deklarues në vitin 2011 si edhe në procesverbalet e deklarimeve pranë ILDKPKI në vitet 2013 dhe në 2016. Kjo vlerësohet se nuk është një pasaktësi në deklarim e personit të lidhur me kancelaren në detyrë. Kjo e dhënë është lehtësisht e verifikueshme dhe e aksesueshme në dokumentacionin e administruar për këtë qëllim. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë çështjes nuk ka peshë në vlerësimin tërësor të pasurisë së kancelares në detyrë znj. {...}.

17.4 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI mbi mungesë dokumentacioni justifikues ligjor situacion/preventiv për vlerën e banesës në fshatin Qelëz, Pukë ndërtuar në periudhën 2005-2009, ku b/shorti zotëron 1/3 pjesë takuese, u krahasua me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe duke u marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, u vlerësua kjo pronë është krijuar në një kohë që bashkëshorti i znj. {...} nuk ka qenë person i lidhur me kancelaren në detyrë dhe ajo nuk mund të mbajë përgjegjësi për fakte të krijuara më parë, pa qenë e lidhur me të, Mungesa e dokumentit situacion/preventiv për vlerën e banesës, jo vetëm që nuk është kërkesë e legjislacionit të zbatueshëm dhe akteve të dala në zbatim të tij, por edhe situata në të cilën është kryer ndërtimi e ka bërë në pamundësi objektive personin e lidhur të mbante dokumentacionin. Shtëpia është ndërtuar pa leje, është bërë nga babai i personit të lidhur, pasi ai ka qenë rezident në Itali në kohën që ajo është bërë, dhe në këtë kohë askush nga familja nuk ishte subjekt deklarimi. Në rrethanat kur një pjesë e punimeve janë bërë pa dokumentacion, punimet janë kryer nga babai i personit të lidhur, dhe faktit që në kohën e ndërtimit asnjë nga familja e tij nuk kishte detyrim për të deklaruar pasurinë, subjekti i lidhur ka qenë në pamundësi për të mbajtur dokumentacion. Bashkëshorti i znj. {...}, në cilësinë e subjektit deklarues (si Kryetar Komune) në deklaratën e interesave private ka deklaruar banesën (shtëpi banimi) në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, pavarësisht faktit që ndërtesa/shtëpia nuk ishte ende e regjistruar në ZVRPP, por as nuk kishin filluar procedurat e legalizimit të saj. Bashkëshorti është thirrur nga ILDKPKI-ja dhe ka sqaruar situatën dhe gjatë kohës që ka qenë subjekt deklarues dhe më pas që nga viti 2015, pas plotësimit prej tij të deklaratës së pasurisë për të nuk është aplikuar asnjë masë administrative nga ILDKPKI-ja për të, fakt i provuar edhe me shkresën nr. 2990/65 prot., datë 29.11.2021, me të cilën ILDKPKI ka informuar KLGJ-në, se për kancelariën në detyrë {...} dhe për personin e lidhur me të nuk ka marrë masa administrative. Në këto kushte, ky konstatim i ILDKPKI nuk është i saktë dhe kurrsesi nuk mund të afektojë vlerësimin e kancelares në detyrë, duke qenë se çështja i referohet një periudhe të largët dhe pa lidhje me të, dhe që në atë kohë ajo nuk ka pasur as mundësinë minimale të parashikimit se si mund të tregonte vigjilencën e duhur për shmangien e një situatë që mund ta penalizonte pas 14 viteve që ndërtimi i shtëpisë ka përfunduar. Lidhur me këtë çështjes, Këshilli mban në konsideratë edhe faktin që pasuria është ndërtuar përpara lidhjes së martesës dhe ku jetojnë prindërit e bashkëshortit.

17.5 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI mbi të ardhurat nga qiraja, sipas kontratave të paraqitura rezultojnë në shumën rreth 4.156.000 lekë, për të cilat është konfirmuar pjesërisht pagesa e detyrimeve tatimore ndaj shtetit dhe gjithashtu nuk konfirmohen pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara nga qiradhënia në shumën 5.800.000 lekë, për periudhën 2003-2011, sipas deklaratës noteriale me nr. 637 rep., dhe nr. 378 kol., datë 26.02.2016, që kanë

shërbyer pjesërisht, si burim për krijimin e pasurive të bashkëshortit, u krahasua me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe duke u marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, u vlerësua ky konstatim nuk ka asnjë pasojë për këtë proces verifikimi për kancelare në detyrë, sepse edhe nga ILDKPKI-ja, ky fakt nuk është cilësuar se sjell ndonjë pasojë në konkluzionin përfundimtar të raportit, pasi të ardhurat nga qiraja janë quajtur të ligjshme. Mospagimi i tatimit nuk ka lidhje as me deklarin e pasurisë, as me burimin e saj, as me deklarin e rremë, as me konfliktin e interesit. Të ardhurat nga qiraja rezultojnë se janë përfituar nga qiramarrës që kanë ushtruar aktivitet tregtar të regjistruar me NIPT pranë organit tatimor dhe sipas ligjeve tatimore, detyrimin për pagimin në organet tatimore të tatimit të qirasë e ka individ përfitues, parashikuar kjo në nenin 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, dhe pikën 2.3.6, të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 të Ministrit të Financave. Burimi i të ardhurave në këtë rast është i ligjshëm, dhe një fakt i tillë është konstatuar edhe nga ILDKPKI duke i llogaritur këto të ardhura si të ligjshme. Për rrjedhojë, Këshilli lidhur me këtë çështje konfirmon qëndrimin e ILDKPKI-së duke i konsideruar këto të ardhura të ligjshme dhe se kancelarja në detyrë znj. {...} ka qenë e saktë dhe e plotë në deklaratën vetting.

18. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur kanë burime financiare për të justifikuar pasuritë e tyre;
- d) deklarimi nga kancelarja në detyrë dhe personi i lidhur, i pasurisë, aseteve ose interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë referuar “*Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*”, të datës 12.03.2021. Deklarimet e pasakta të konstatuara nga kontrolli i kësaj deklaratë, nuk përbejnë shkak të mjaftueshëm për skualifikimin e kancelares në detyrë znj.{...}. Ky konkluzion arrihet duke iu referuar: (i) konstatimeve të organit kompetent për deklarin dhe kontrollin e pasurive, (ii) vlerësimit të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e pasurive të administruar gjatë hetimit administrativ në raport me qëndrimin e subjektit në proces verifikimi, (iii) mos evidentimit të qëllimit për mosdeklarim apo deklarim të paplotë të subjektit në raport me mangësitë e konstatuara.

Ç. Për kriterin e figurës

19. Për kancelaren në detyrë {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016.

20. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kancelaren në detyrë {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kancelares në detyrë {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

21. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës, KLGJ me shkresën nr. 5594 prot., datë 30.10.2020, kërkoi vënien në dispozicion të formularëve të vetëdeklarimit për kancelarët në detyrë nga Ministria e Drejtësisë, si organi i emërtesës së kancelarëve, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*. Mbi këtë kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë ka përcjellë në Këshill, shkresën me nr. 6906 prot., datë 12.11.2020, sipas të cilës formularët e vetëdeklarimit të kancelarëve në detyrë janë pranë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

22. Me shkresën nr. 5594/2, datë 19.11.2020, iu kërkua Departamentit të Administratës Publike vënia në dispozicion e formularëve të vetëdeklarimit për kancelarët në detyrë. Mbi këtë kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Departamenti i Administratës Publike ka përcjellë në Këshill, me shkresën nr.6084/1 prot., datë 24.11.2020, të gjithë informacionin e kërkuar dhe të përpunuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

23. Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, nga ana e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit, janë kryer verifikimet e thelluara të të dhënave të formularit të vetë deklarimit për gjendjen gjyqësore dhe gjendjen civile të kancelares në detyrë. Në vijim të përgjigjeve të shkresave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme²³, nga nëpunësi përgjegjës i Strukturës së Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk u konstatuan mangësi në të dhënat e deklaruara nga kancelari në detyrë në formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të ligjit, duke konkluduar se Znj. {...} *“- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 26.04.2016; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëeb të KLGJ-së; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore, rezulton i padënuar nga gjykatat penale shqiptare; - Sektori i gjendjes civile, me vendimin e Këshillit Popullor datë 11.05.1983 përbërësit e gjendjes civile familjare të shtetases ka ndryshuar mbiemrin nga “{...}” në “{...}”; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar*

²³Shih shkresën nr. 5347/142 prot., datë 23.06.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit.

verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

24. Me shkresën nr. 5833/7/2, datë 04.12.2020, iu kërkua Prokurorisë së Përgjithshme dhënia e informacionit të nevojshëm, në lidhje me aspektet si më poshtë:

- nëse subjektet në proces verifikimi kanë marrë cilësinë e personit në hetim në një procedim penal;
- nëse ndaj subjekteve në proces verifikimi është zbatuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror;
- nëse ka të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara, në të cilat përmendet emri i subjektit në proces verifikimi.

Mbi këtë kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme²⁴ ka përcjellë informacionin nga të 22 prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Referuar përmbajtjes së secilit nga 22 informacionet e përcjella, nuk rezultoi që kancelarja në detyrë {...} të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj tij të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, të jetë zbatuar ndonjë masë sigurimi me karakter personal apo pasuror dhe as ka pasur të dhëna për procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara.

25. Gjithashtu, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor²⁵, Prokuroria e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, me shkresën nr. 5679/20 prot., datë 21.04.2021, ka konfirmuar se nuk rezultojnë të dhëna që znj. {...} të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj saj të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

26. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor²⁶, Byroja Kombëtare e Hetimit, me shkresën nr.281 prot., datë 28.06.2021, ka informuar se nuk disponon asnjë informacion në lidhje me kancelaren në detyrë {...}.

²⁴Shkresa nr. 1762/1 Prot., datë 11.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet; shkresa nr. 1367/1 Prot., datë 14.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë; shkresa nr. 3850/1 Prot., datë 14.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat; shkresa nr. 420/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; shkresa nr. 1369/1 Prot., datë 16.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat; shkresa nr. 3768 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë; shkresa nr. 365/1 Prot., datë 16.02.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë; shkresa nr. 2955/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; shkresa nr. 8284/1 Prot., datë 08.03.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin; shkresa nr. 1239/1 Prot., datë 16.03.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec; shkresa nr. 15418/1 Prot., datë 28.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; shkresa nr. 3768 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë; shkresa nr. 11820/1 Prot., datë 05.01.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; shkresa nr. 8658/1 Prot., datë 17.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë; shkresa nr. 1631/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës; shkresa nr. 12300 Prot., datë 18.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; shkresa nr. 9766/1 Prot., datë 17.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; shkresa nr. 12931/1 Prot., datë 18.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; shkresa nr. 9360/1 Prot., datë 16.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; shkresa nr. 6251 Prot., datë 20.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; shkresa nr. 2407 Prot., datë 23.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër; shkresa nr. 1025 Prot., datë 31.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë; shkresa nr. 2616/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

²⁵Shkresa nr.5679/19 prot., datë 13.04.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

²⁶Shkresa nr. 2805/prot., datë 14.06.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për sa më sipër, nga përmbajtja e akteve të mësipërme konfirmohet se kancelarja në detyrë znj. {...}, nuk rezulton të jetë marrë në cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal apo të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror. Sa më sipër konfirmohet se për kancelaren në detyrë {...} nuk ka elementë të cenimit të figurës dhe se deklarimi i saj për këtë komponent të vlerësimit ka qenë i plotë, i saktë, i vërtetë dhe në përputhje me ligjin.

27. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kancelaren në detyrë {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) kancelarja në detyrë ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
- b) kancelarja në detyrë ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 83, Seksioni C, Kreu VI të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kancelaren në detyrë nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) për kancelaren në detyrë nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për vazhdimin e marrëdhënies së saj të punës në shërbimin civil gjyqësor.

III. KONKLUZIONE

28. Referuar përcaktimeve të Vendimit nr. 424/2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për kancelaren në detyrë në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

29. Bazuar në sa është parashtruar më lart mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë e figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kancelarja në detyrë përmbush këto kritere dhe nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kancelares në detyrë dhe lejimin e saj për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 83, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore e ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin dhe lejimin për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional të kancelares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. {...}.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kancelares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR